Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. (8)28. GUSHT 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

ESE

Si e shpalli "persona nongrata" U. Econ pushteti ynë i djathtë

NGA: **AGRON TUFA - FAQE 7**

REPORTAZH

Mes emigrantësh shqiptarë në Gjenova

NGA: **SHAQIR SKARRA - FAQE 5**

KULTURË

Dukuri të letrave të Ibrahim Shytit me dibranin Josif Bageri

NGA: **BERNARD ZOTAJ - FAQE 11**


Disa ide për ngritjen dhe funksionimin e Universitetit të Dibrës

UNIVERSITETI I DIBRËS, shtëpia e mendimit shqiptar

Nga **HYSEN UKA**

Prej kohësh, ne një grup entuziastësh, kemi rrahur mes nesh idenë, që edhe në Dibër, duhet të ngrihet një institucioni i lartë arsimor, në nivel universiteti. Këtë ide e kemi artikuluar e debatuar fillimisht ndër mjediset intelektuale, me kontribute të afirmuara në fushën e arsimit dhe të kërkimit shkencor dhe të orientuar nga puna pedagogjike. Mendoj se tashmë është koha e duhur, apo e fundme, që jo vetëm të promovojmë idenë tonë, por edhe të punojmë fort që, fatin për të patur një universitet, që do të iluminojë një profil krejt të veçantë, ekzistencial për qenien tonë kombëtare, botën e mendimit shqiptarë, ta ketë Dibra jonë. Në Dibër, është në vendin e duhur, është në truallin e vet, të lindë e të nisë të rrezatojë Universiteti i Mendimit Shqiptar, (UMSH- Dibra; UMSH-Skanderbeg apo UMSH-Arbëria etj ….). Sigurisht, idetë duan kohën dhe kushtet e veta tokësore, për të zbritur nga qiejtë e utopive. Dhe për projektin tonë, të Universitetit të Mendimit Shqiptar, tashmë janë të gjitha kushtet. Dibra, për një shekull e ndarë dhe e kryqëzuar në kryqin e kufirit të dy botëve, merr frymë e çliruar, ajo tashmë ka shpërthyer tkurrjen e po ringjallet çdo ditë. Udhëtarë nga Gjilani e Metvegja, nga Shkupi, Tetova e Gostivari që udhëtojnë për në Tiranë, Durrës e Vlorë; e vlonjatë, durrsakë, shkodranë e tiranas që shkojnë për në Tetovë, Shkup, Prishtinë, e deri në Sofje e Stamboll, përshëndetën për çdo ditë me Dibrën tonë.

(Më shumë lexoni në faqen 3-4)



Universiteti i Mendimit Shqiptar, do të jetë institucion i arsimit të lartë, që jep dijeni dhe kryen veprimtari kërkimore e studimore dhe siguron arsimim për gjithë jetën. Universiteti i Mendimit ka për qëllim, të jap njohuri të thelluara për mendimin si produkt i trurit të njeriut në shoqëri; kalimin nga perceptimet fillestare përmes shqisave, në nivelet e abstragimit e të arsyetimit, duke krijuar sisteme njohurish në fusha të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore, të formalizuara,të shprehura e të transmetuara përmes gjuhës.

Olldashi: "Studiot projektuese të zgjedhin alternativën më të shkurtër për Rrugën e Arbërit"

Faqe 2



AKTUALITET

Dibranët lypin investime e jo fjalë boshe

Nga: **REXHEP TORTE** - Faqe 6

PROFIL

Banjat e Dibrës

Nga: **REXHEP TORTE** - Faqe 8

STUDIM

Auditimi - semantika dhe etimologjia

Nga: **QERAM CIBAKU** - Faqe 10

HISTORI

Ataturku, krijuesi i Turqisë moderne

Nga: **SAKIP CAMI** - Faqe 13

KULTURË

Kënga qytetare dibrane

Nga: **PËRPARIM TOMÇINI** - Faqe 15

cyan magenta yellow black 1

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Sokol Olldashi, bën një panoramë të punimeve në Rrugën e Arbërit dhe thekson angazhimin e qeverisë shqiptare për ndërtimin e Rrugës së Arbërit


Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Selman Mziu, Qeram Cibaku, Përparim Tomçini, Bernard Zotaj, Xhelal Roçi, Kujtim Boriçi, Ymer Keta, Beqir Sina, Sakip Cami, Zabit Lleshi, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër. Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Redaksia:
Në Dibër:
Rexhep Torte
Në Athinë:
Abdurrahim Ashiku
Në Itali:
Selman Mziu
Në New York:
Beqir Sina
Në Tiranë:
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,
Naim Plaku

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. (04) 2233 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

MINISTRI I TRANSPORTEVE DHE TELEKOMUNIKACIONIT FLET PËR RRUGËN E ARBËRIT

Olldashi: "Studiot projektuese të zgjedhin alternativën më të shkurtër për Rrugën e Arbërit"

Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Sokol Olldashi u shpreh në fillim të Gushtit për mediat se ndërtimi i Rrugës së Arbërit shkurton distancën aktuale mes Tiranës dhe Shkupit me rreth 100 km, ndaj dhe do të procedohet me të gjithë shpejtësinë e mundshme për ndërtimin e kësaj arterie kryesore.

Sipas tij, janë instruktuar studiot projektuese të zgjedhin alternativën më të shkurtër të Rrugës së Arbërit, pavarësisht kostove financiare që mund të jenë më të larta.

Sipas kreut të MPPTT-së, Olldashi, tre lotet kanë ecuri të mirë. "Nga Bulqiza deri në Gurin e Bardhë projekti është tenderuar vitin që kaloi dhe presim përfundimin e tij shumë shpejt, ndërsa dy lotet e tjera nga Guri i Bardhë deri në Qafë Murriza dhe nga Qafë Murriza deri në Tiranë, janë në procedura tenderimi", vlerësoi ai.

Z.Olldashi theksoi se për secilin lot do të aplikohet e njëjta procedurë. "Me të mbaruar projekti do të certifikohet nga drejtoria teknike për parametrat e tij, më pas do të tenderohet në mënyrë që me këtë rrugë të ecet sa më shpejt, pasi konsiderohet një arterie e rëndësishme për zhvillimin jo vetëm të infrastrukturës së vendit dhe lidhjen e transportin me zonat veriore të Shqipërisë, por edhe me Maqedoninë", tha ministri Olldashi.

Sipas tij, mundësitë financiare janë, por duhet të përfundojnë projektet dhe të zgjidhet alternativa më e mirë. "Ne kemi instruktuar studiot projektuese të zgjedhin alternativën më të shkurtër, pavarësisht kostos financiare që mund të jenë më të larta", shprehet Olldashi.



Punime në rrugën e Arbrit

Ndërtimi i Rrugës së Arbërit shkurton në mënyrë të ndjeshme rrugën e transportit që lidhin Tiranën dhe portin e Durrësit me Dibrën, Peshkopinë, Matin, Shkupin.

Rruga e Dibrës, e quajtur Rruga e Arbërit, është e gjatë 75 kilometra. Sipas projektit, rruga parashikohet të përshkohet me shpejtësi mesatare 80 kilometra në orë, duke mënjanuar në maksimum ngjitjet malore edhe se ndërpret vargmale me lartësi mbi 1500-2000 metra. Kjo rrugë do të kalojë në 10 zona, ku do të shkurtojë 70 kilometra rrugën e sotme nga Burreli. Pra fillimet e saj i ka në Tiranë më pas në Zall Dajt, Guri i Bardhë, Ura e Vashës, Plani i Bardhë, Bulqizë, Ura e Çerenecit, Gjoricë, Dibër. Aktualisht rruga ekzistuese shtrihet në Tiranë, Milot, Burrel, Bulqizë, Shupenzë, Maqellarë, Bllatë, Dibër. Kjo rrugë është e gjatë 173 kilometra dhe është në stilin gjarpërues.

Ndërkohë vazhdimi i Rrugës së Arbërit në territorin e Maqedonisë, pas kalimit të kufirit shqiptar fillon në Gjoricë, aty ku lugina e Drinit në Zatarajca, poshtë urës së vjetër me harqe të Spiles, e cila është mbuluar nga diga e hidrocentralit të Dibrës së Madhe. Nga Dibra në drejtim të Gostivarit rruga kalon nëpër grykën e Radikës, duke vazhduar më tej në drejtim të Gostivarit, Tetovës, Shkupit e Sofjes.

ATSH

Shkurt

Peshkopia pa ujë, shkaku ndërhyrjet në ujësjellës

Rreth 20 mijë banorë në qytetin e Peshkopisë po vuajnë mungesën e ujit të pijshëm. Banorë pohojnë se prej disa ditësh vazhdojnë të furnizohen me ujë vetëm 90 minuta për çdo ditë. Një gjendje e tillë, thonë ata, nuk mbahet mend të ketë ndodhur ndonjëherë në këtë qytet, gjë që ka shkaktuar mjaft probleme për këta banorë. Po sipas banorëve, oraret e furnizimit me ujë janë nga ora 06:30 deri në orën 07:00 të mëngjesit dhe nga ora 19:00 deri në orën 20:00 të mbrëmjes. Në ndërmarrjen e ujësjellësit të këtij qyteti, jashtë një prononcimi zyrtar, mëson se një situatë e tillë vjen nga shterimi i ujit të burimeve nga ku ai merret. Ndërsa vetë qytetarët, pohojnë se kjo situatë e krizës së ujit të pijshëm vjen nga ndërhyrjet e fshatarëve të zonave përreth këtij qyteti në tubacionin e ujësjellësit. Ata marrin ujë në mënyrë të jashtëligjshme për vaditjen e tokave, ndërsa një arsye tjetër është shpërdorimi i ujit nga lavazhet e panumërta të makinave, që ka qyteti. Një arsye tjetër e mungesës së ujit është edhe shtimi tejet mase i lavazheve të makinave. Situata bëhet edhe më paradoksale po të kemi parasysh se para dy vitesh, për ndërtimin e një ujësjellësi të ri për këtë qytet u shpenzuan jo pak, por rreth 3,5 milionë euro. Por ky investim rezultoi krejtësisht i dështuar dhe për çudi asnjë nuk ka mbajtur qoftë edhe një grimë përgjegjësie për këtë dështim. **(Shqip)**

Turistët nga Maqedonia "ringjallin" Bllatën

Gjatë muajit gusht, numri i turistëve maqedonas, që kanë hyrë në pikën doganore të Bllatës, për të kaluar pushimet verore në vendin tonë, është dyfishuar në krahasim me një vit më parë. Sipas burimeve nga policia kufitare e kësaj dogane bëhet me dije se në gjysmën e parë të gushtit, nga Maqedonia në Shqipëri kanë hyrë 5522 shtetas. Po sipas këtyre burimeve, mësohet se shtetasit maqedonas, preferojnë për të kaluar pushimet verore në plazhet e Durrësit, Shëngjinit dhe Velipojës, por nuk mungojnë edhe rastet e frekuentimit të plazheve më në Jug të vendit. Nga autoritete të policisë kufitare mësohet se kohët e fundit, mes dy policive lokale, Dibër-Peshkopi, ekziston një bashkëpunim i shkëlqyer marrëdhëniesh në nivel institucional. Nga 1 janari i këtij viti, deri në gjysmën e parë të gushtit, në territorin shqiptar, nga pika doganore e Bllatës, kanë hyrë 10061 shtetas, nga të cilët 8783 shtetas të Maqedonisë. Ndërsa nga Shqipëria në Maqedoni janë regjistruar të hyjnë 9462 vetë, prej të cilëve 8239 maqedonas dhe të tjerët shqiptarë. Por ndërsa rritet ndjeshëm fluksi i banorëve që hyjnë dhe dalin në këtë pikë doganore, ai i mallrave nuk ka pësuar asnjë ndryshim, pasi nga kjo pikë doganore nuk lejohet ende kalimi i mallrave, përjashtuar vetëm ato që përdoren për ndërtim, si tulla dhe tjegulla.

Durrës, bizneset maqedonase "inspektojnë" portin detar

Shqipëria tërheqëse, jo vetëm në turizëm për maqedonasit, por edhe në biznes. Përfaqësues të dhjetëra kompanive maqedonase kanë planifikuar një vizitë në portet e Durrësit dhe Tivarit, me qëllim mbledhjen e informacioneve konkrete mbi realizimin e kontratave për eksport-importe. I vendosur në qendër të bregdetit shqiptar, Porti Detar i Durrësit shihet si një urë e rëndësishme tranzitimi mes botës dhe Maqedonisë. Mundësia për të zgjedhur Portin Detar të Durrësit I mbetet prespektivës, pasi të vihet në funksion edhe Rruga e Arbërit, e cila e afron ndjeshëm Shkupin me Durrësin.

IDE/ DISA MENDIME MBI UNIVERSITETIN E DIBRES. IDE DHE MENDIME PER NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E TIJ

Universiteti i Dibrës, shtëpia e mendimit shqiptar

Në Dibër, është në vendin e duhur, është në truallin e vet, të lind e të nisë të rrezatojë Universiteti i Mendimit Shqiptar

Nga **HYSEN UKA**

Prej kohësh, ne një grup entuzi astësh, kemi rrahur mes nesh, idenë që edhe në Dibër, duhet të ngrihet një institucion i lart arsimor, në nivel universiteti. Këtë ide e kemi artikuluar e debatuar fillimisht ndër mjediset intelektuale, me kontribute të afirmuara në fushën e arsimit dhe të kërkimit shkencor dhe të orientuar nga puna pedagogjike. Mendoj se tashmë është koha e duhur, apo e fundme, që jo vetëm të promovojmë idenë tonë, por edhe të punojmë fort që, fatin për të patur një universitet, që do të iluminojë një profil krejt të veçantë, ekzistencial për qenien tonë kombëtare, botën e mendimit shqiptarë, ta ketë Dibra jonë. Në Dibër, është në vendin e duhur, është në truallin e vet, të lind e të nisë të rrezatojë Universiteti i Mendimit Shqiptar, (UMSH-Dibra; UMSH-Skanderbeg apo UMSH-Arbëria etj ....)

Sigurisht, idetë duan kohën dhe kushtet e veta tokësore, për të zbritur nga qiejtë e utopive. Dhe për projektin tonë, të Universitetit të Mendimit Shqiptarë, tashmë janë të gjitha kushtet. Dibra, për një shekull e ndarë dhe e kryqëzuar në kryqin e kufirit të dy botëve, merr frymë e çliruar, ajo tashmë ka shpërthyer tkurrjen e po ringjallet çdo ditë. Udhëtarë nga Gjilani e Metvegja, nga Shkupi, Tetova e Gostivari që udhëtojnë për në Tiranë, Durrës e Vlorë; e vlonjatë, durrsakë, shkodranë e tiranas që shkojnë për në Tetovë, Shkup, Prishtinë, e deri në Sofje e Stamboll, përshëndetën për çdo ditë me Dibrën tonë. Rruga e Arbërit, e cila ditë pas dite po zgjatet drejt Adriatikut, është vetë kordoni jetësor, që do t'ju jap jetë tw gjitha ideve e vizioneve tona progresive, është ajo që po thyen e shkallmon çdo ditë, kryqin ku bahej mbërthyer, prej një shekulli, kjo anë e shqiptarisë, ky log i mendjes dhe burrërisë së shqiptareve. Kjo është edhe rruga nga do të vijnë e shkojnë studentët, pedagogët, studjues e shkencëtar, për në Dibër, e cila do të mbajë për to, si në pëllëmbët të dorës, nën dritë, paqe e qetësi, një Universitet, ku do të endet krejt i pastër me dritën e diturisë, pëlhura e mendimit shqiptar, ku me zellin dhe përpikmërin e bletës, ato do ta mbledhin e ndërtojnë, atë ngrehinë me arkitekturë hyjnore, ku do të hojëzohet mendimi shqiptar. Dhe jo vetëm kjo rrugë, por edhe rruga Durrës-Kukës-Prishtinë, apo korridori lindor-qëndror, Kukës-Dibër-Librazhd-Pogradec, e deri në Tre Urat e Permetit, do të jenë udhët ku do të qarkullojnë jo vetëm njerëzit e bizneseve, (mallrave, shërbimeve, kapitaleve etj,) por edhe njerëzit e arsimit e shkencës, studentë e pedagogë etj, me sytë tek Univerersiteti i Dibrës. Dibra, duke u gjendur në një pozicion aksiometrik, për mbarë hapsirat shqiptare, dhe me thellimin e vazhdueshëm të proceseve eurointegruese në rajonin e Ballkanit, do të shndërrohet shpejtë edhe në qendër e rëndësishme ku do të gravitojnë, një pjesë e madhe e flukseve e dinamikave zhvillimore rajonale, e më gjërë. Në të kundërt kurrë nuk do të kemi një funksionalizim të hapsirave kombëtare mbarëshqiptare.

Dibrën, e kanë quajtur "grihëri i mendjes", "kulla e mendimit shqiptar", etj; të diplomuar në Universitetin e Oksfordit që kanë patur rastin të vijnë në Dibër e të njihen me urtësin e saj, e kanë quajtur "Universitet", dhe e kanë vënë në krahë me universitetin e tyre të Oksfordit. I përmendëm këto, jo për kreni, apo të madhëk krahinor, të cilin dibranet nuk e pëlqejnë (bile e quajnë ves), por për të evidentuar një argument, një fakt tashmë të njohur, se procesi mental, artikulimi i mendimit në këtë rajon, ka një traditë dhe është i njohur e i certifikuar si vlerë kombëtare.

Që nga periudha parashkrimore, si mençuri popullore, e deri në ditët tona, ku vlerat mentale universalizohen e verefikohen në referenca mbarë njerëzore, kombi shqiptar ka krijuar vazhdimisht produkt të çmuar të mendimit, i cili për shkaqe historike, nuk ka mundur të sistemohet e të strukturohet, por është mbajtur i fraksionuar, anonim, apo është bjerrur.

Universiteti i Mendimit Shqiptar, do të jetë institucion i arsimit të lartë, që jep dijeni dhe kryen veprimtari kërkimore e studimore dhe siguron arsimim për gjithë jetën. Universiteti i Mendimit ka për qëllim, të jap njohuri të thelluara për mendimin si produkt i trurit të njeriut në shoqëri; kalimin nga perceptimet fillestare përmes shqisave, në nivelet e abstragimit e të arsyetimit, duke krijuar sisteme njohurishë në fusha të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore, të formalizuara, të shprehura e të transmetuara përmes gjuhës.



Mendimtari. Sculpture nga Rodin"

Çdo ligjeratë apo formë komunikimi në shqip, në Dibër apo kudo në hapsirat mbarë shqiptare, përzgjedh e funksionalizon nuanca konceptuale e kuptimore, që e ngren ligjërimin në nivele filozofimi, që prodhon mendime e ide, në nivel të lartë dhe që e detyrojnë pritësin e mesazhit të jetë i vëmendshëm e të impenjohet, për t'u përgjigjur në atë nivel.

Nuk preferohet ligjërimi i thjeshtësuar apo i rëndomt. Kjo mënyrë, komunikimit është një proces në përsosje të vazhdueshme në përditësin e tij, një proces kërkimi e krijimi të vazhdueshëm, që e zbukuron, deri në ornamentalizim gjuhën e mendimin, dhe duke u përdorur gjërësisht e vazhdimisht krijon edhe traditet dhe kodet e tij.

***

Dhe pas entuziazmit, i vjen radha pyetjes: -Po si do të nisë e do të funksionoj universiteti ynë? Ata që i njohin mirë këto punë, do të mbledhin buzët e do të thonë: -ç'po na thotë ky kokë krisur, pse kaq e thjesht është; si të qerosh patate është të ngresh një universitet?

Po, duhet kjo e duhet ajo,...pa harruar të të lëshojnë si grusht të fundit se: duhen edhe milona e miliarda, ...dhe të rëndisin një listë të frikshme, të cilën për hir të së vërtetës edhe unë, me javë e muaj, në mos më shumë e kam vërtitur në mokrën time të mendimit, e ndoshta edhe më ka trembur ndonjëherë.

Por, në fakt nuk është aq e frikshme. Mësimi konfucian se edhe udhëtimi më i largët, fillon me një hap... na frymëzon ta hedhim hapin e parë, pa humbur kohë, që sa më shpejt, të shkojmë më larg. Për Universitetin tonë, nuk nevojiten ekstra laboratorë, për të krijuar kushte, jashtëtokësore, të makrobotëve apo laborator që bëjnë zero forcën tërheqëse të tokës.

Para ka mjaftueshëm për çdo punë e qëllim të mirë, por sigurisht jo për matrapazë e qelepirxhinj. Komuniteti dibran, kudo ku është, në Shqipëri, Amerikë, Europë, e kudo nëpër botë, ka aq fuqi ekonomike, sa të lëshojë satelitin e tij në hapsirë, e jo më për gjëra toksore. Por, sigurisht, ai jep para, për ata që kanë projekte të qarta, dinë mirë çfarë dhe si duhet t'i realizojnë projektet e tyre.

Kombi shqiptar ka krijuar vazhdimisht produkt të çmuar të mendimit, i cili për shkaqe historike, nuk ka mundur të sistemohet e të strukturohet, por është mbajtur i fraksionuar, anonim, apo është bdjerrur. Çdo ligjeratë apo formë komunikimi në shqip, në Dibër apo në kudo në hapsirat mbarë shqiptare, përzgjedh e funksionalizon nuaca konceptuale e kuptimore, që e ngren ligjërimin në nivele filozofimi, që prodhon mendime e ide, në nivel të lartë dhe që e detyrojnë pritësin e mesazhit të jetë i vëmendshëm e të impenjohet, për t'u përgjigjur në atë nivel.

Edhe mjete punë, edhe lëndë e parë, për Universitetin e Mendimit është gjuha, gjuha jonë shqipe, që në fillesat e saja parshkrimore e deri tek laboratori i sofistikuar mental i shkrimtarëve, ideologëve, vizionarëve, filozofëve e shkencëtarëve në të gjitha hapsirat shqiptare.

Në Universitetin e Mendimit Shqiptar, me të gjithë kuptimet dhe vlerat e saj, "e para është fjala". Pra, në ndërtimin strukturor të programeve të Universitetit, do të ketë fakultete që do të përditësojnë e harmonizojnë midis tyre, disiplina shkencore nga Filologjia, dhe nëndegët e saj Semasiologjia dhe Sociolinguistika, Historia, Albanologjia, Filozofia, Estetika, Etimologjia etj, të gjitha në funksion të Dianologjisë (Dianoetikës), shkencës për mendjen dhe të menduarit në përgjithësi dhe për të gjykuarin racional në veçanti, doktrinën për mendjen dhe të menduarit. Dianoetika, sipas Hamiltonit - është ajo (shkencë), me anë të së cilës vihet në pah aftësia discursive e njeriut për dallim nga njohja në përgjithësi, nga njohja që është vetëm neotike.

(Vijon në faqen 4)

Një ide interesante se Dibra mund të ketë një universitet.
Krijimi, emërtimi, funksionimi, financimi, programi dhe plot ide
të tjera se si mundet të ngrihet dhe të funksionojë Universiteti i Dibrës

Universiteti i Dibrës, shtëpia e mendimit shqiptar

(Vijon nga faqja 3)

Procesi mësimorë në Universitetin e mendimit do të përmbajë ndër të tjera module si: Hyrje në sistemet e mendimit apo Hyrje në mendimologji (një hyrje e shkurtër); Histori e mendimit të lashtësisë, (ndërdisiplinore-botëror dhe shqiptar); Histori e mendimit të mesjetës (ndërdisiplinor, botëror dhe shqiptar); Histori e mendimit bashkëkohor (ndërdisiplinor, botëror dhe shqiptar); Futurologji (mendimi futuristik); Gjuhësi konceptuale (në nivel konceptesh); Gjuhësi mendimi (ndërtim i strukturave të mendimi) apo Gjuhësia dhe mendimi; Semasiologjia si shkenca për kuptimin, (shenjë-koncept-referet (që është sendi), më tej kalimi nga kuptimi i fjalës në kutimin e sintagmës ose i frazës) kuptim i ligjerim mendimi); Sociologji mendimi; Sisteme mendimi: Sistemi i mendimit filozofik); Sistemi i mendimit estetik (letrar e artet tjera); Sistemi i mendimit shkencor (natyror- shoqëror); Sistemi i mendimit fetar (tre konfeksionet), Universalizmi i Mendimit (mendimi në epokën e globalizimit), Mentaria popullore apo Urtësi popullore, etj.

Universiteti do të trajtojë edhe disiplina si Higjienë Mendimi dhe Shendeti Mental, si dhe Trajinim Mental, etj, (Përshkrime më të hollësishme të programeve janë në përpunim dhe do të bëhen të njohura në numrat e ardhshëm të gazetës, me qëllim për t'ju nënshtruar pastaj, gjykimit e përmirësimit nga një staf profesionistësh, për të dhënë një struktur programore të plotë, të strukturuar mirë e që gëzon vlerësim dhe besimin e au-

Në Universitetin e Mendimit Shqiptar, me të gjithë kuptimet dhe vlerat e saj, "e para është fjala". Pra, në ndërtimin strukturor të programeve të Universitetit, do të ketë fakultete që do të përditësojnë e harmonizojnë midis tyre, disiplina shkencore nga Filologjia, dhe nëndegët e saj Semasiologjia dhe Sociolinguistika, Historia, Albanologjia, Filozofia, Estetika, Etimologjia etj, të gjitha në funksion të Dianologjisë (Dianoetikës), shkencës për mendjen dhe të menduarit në përgjithësi dhe për të gjykuarin racional në veçanti, doktrinën për mendjen dhe të menduarit.

toriteteve të larta shkencore)

Pra, struktura programore e fakulteteve të Universitetit të Mendimit, do të ketë objekt njohjen dhe studimin e shndërrimeve historike që ka pësuar mendimi në përgjithësi dhe mendimin shqiptarë në veçanti.


Sikurse gjuha edhe mendimi, ka karakter historik, pra ka lindur në format e tij më të thjeshta dhe është zhvilluar deri në stadin e sotëm të zhvillmit shoqëror, për të shkuar më tej, në epokën e globalizmit, por duke ruajtur markimin si mendim shqiptarë.

Sigurisht, ta përgatisësh këtë produkt për botën e konkurencës kërkon të kryhet punë e madhe dhe e vështirë nga kapacitetet e larta shkencore. Universiteti i Mendimit Shqiptar, do të jetë institucion i arsimit të lartë, që jep dijeni dhe kryen veprimtari kërkimore e studimore dhe siguron arsimim për gjithë jetën. Universiteti i Mendimit ka për



qëllim, të jap njohuri të thelluara për mendimin si produkt i trurit të njeriut në shoqëri; kalimin nga perceptimet fillestare përmes shqisave, në nivelet e abstragimit e të arsyetimit, duke krijuar sisteme njohurishë në fusha të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore, të formalizuara, të shprehura e të transmetuara përmes gjuhës. Duke e harmonizuar këtë formim arsimor edhe me Edukimin Institucional (përmes një dege të Fakultetit të Administratës Publike), dhe aftësimin në përdorimin praktik tw mjeteve dhe resurseve gjuhësore, për të sëndërtuar ide e mendime, nga niveli i esesë e deri në punime të profilit të lartë, në fusha të ndryshme. Kjo do të zgjidhë njëkohësisht edhe problemin e tregut të punës, për ato që do të zgjedhin të studjojnë në Universitetin e Mendimit. Këta studentë duke marr këto njohuri do të jenë të preferuar për të gjitha nivelet e administratës publike dhe në sektorin privat. Ato do të realizojnë komunikim të qartë e të këndshëm si partner në fusha të ndryshme ku do të zgjedhin të veprojnë, duke kapërcyer kështu, një nga problemet më të mëdha që ka sot funksionimi i jetës sonë, atë të përdorimit të valencave të ndryshme kuptimore për probleme të njëjta, e duke sjellë si rezultat kriza komunikimi e bashkëveprimi. Për ato që do të zgjedhin të thellohen në studimin e proceseve dhe fushave të mendimit, është përpara një shesh i madh, me produkt mental shqiptar, që pret të ndërtohet e të ngrehin me të ngrehina madhështore e mendimit shqiptar. Sigurisht, kjo është një punë për mendje të ndritura që një ditë do të dalin edhe nga Universiteti i Mendimit Shqiptar- Dibra.

H. UKA




NIGJARE VILÇANI (DIDI) I SHKRUAN ABDURAHIM ASHIKUT

Jeta ime si mësuese në Dibër

Shoku Abdurahim!

Lexova me vëmendje shkrimin tuaj me titull "Mësuesit – më të përkushtuarit dhe të harruarit". Të them të drejtën ky shkrim më preku thellë më zemër, mbasi më ktheu në kujtimet e 44 vjetëve më parë, në moshën time më të re.



Akoma pa mbushur 16 vjeç, pas një kursi metodik pedagogjik, lash Beratin dhe erdha në Peshkopi, fillimisht në fshatin Brezhdan, i cili më ka lënë mbresa të paharruara në kujtesë dhe pastaj në kufi, në fshatin malor të Cerjanit ku e ndjeva veten në shtëpinë time. Pra për herë të parë hyra në jetë, në punë si arsimtare për tu dhënë njohuritë e para të gjuhës sonë të bukur shqipe vocërrakëve aq të etur për dije. Në këtë kohë aq të vështirë për të jetuar ku përveç varfërisë qemë të detyruar të përballemi edhe me kërcënimet dhe ofendimet e disa skeptikëve apo keqdashësve që e shihnin si luks duke ndikuar që fëmijët e sidomos vajzat të mos ndiqnin shkollën. Pra ne arsimtarëve të atij brezi na duhej jo vetëm të jepnim mësime në shkollën fillore etj. por edhe të shkonim në çdo familje, shtëpi më shtëpi për t'u mbushur mendjen disa prindërve që hezitonin të dërgonin fëmijët në shkollë si dhe për të grumbulluar të gjithë analfabetët në kurset e luftës kundër analfabetizmit që i zhvillonim mbrëmjeve pas pune.

Për mungesë të klasave dhe numrit të domosdoshëm të arsimtarëve na duhej të jepnim mësim në klasa kolektive. Puna kaq e ngarkuar na detyronte të përgatisnim planet e punës për dy klasa dhe kurset e analfabetizmit deri natën vonë. Por kjo punë, megjithëse e lodhshme nuk na demoralizonte, përkundrazi ndjenim sadisfaksion. Ne e bënim këtë sepse e quanim për detyrë ndaj brezave, e quanim të domosdoshme dhe në asnjë mënyrë nuk na shkonte mendja se të kesh dhënë apo të japish mësim në fshat është ofendim apo ke qenë dhe je i persekutuar. Një mendim i tillë është ofezë për çdo patriot, ofezë për rilindësit që kthenin shtëpitë e tyre në shkolla dhe nën kërcënimin otoman apo të shovinistëve grekë, serb apo maqedonas, u jepnin dritë, pra u jepnin arsim fëmijëve shqiptarë të lënë në errësirë duke sakrifikuar edhe jetën. E pra, këta qenë frymëzimi për ne dhe e quanim për nder të mësonim fëmijët e malësorëve të lënë në errësirë e injorancë pa shkrim e lexim. Sa kënaqësi është për ne kur shihnim që fëmijët e këtyre malësorëve të zgjuar, me gjithë që në kondita shumë të vështira, mësonin me vëmendje.

E ndjeva veten krenare kur pashë nxënës të mi nga Brezhdani e Cerjani i Peshkopisë, nga Kukësi në Veri, nga fshati malor i Bogdanit në Berat apo nga Saranda në Jug të Shqipërisë, etj. ku unë kam punuar si arsimtare të jenë bërë me arsim të lartë e të mesëm pedagogjik, mjekësor, agronomi etj. Pavarësisht nga trajtimi material, i cili edhe sot është tepër diskriminues për arsimtarin dhe le për të dëshiruar, gjithashtu pavarësisht nga mohimi që iu bë personit tim kur erdha në Tiranë për të vazhduar punën e dashur të arsimtares, me gjithë arsimin pedagogjik që kisha, ndjehem krenare dhe aspak e penduar, mbasi gëzoj simpatinë e ish nxënësve të mi kudo që janë. Le tu rëndojë në ndërgjegjen e tyre ajo padrejtësi, atyre që e bënë.

Ju falënderoj për kujtimet që më zgjuat, kujtime të cilat i ruaj edhe në marrëdhënie me shumë familje të nxënësve të mi, kudo që kam qenë.

Ju përshëndes
Nigjare Didi (Velçani)
Tiranë 7.7.1993

Dërgon Nigjare Didi (Velçani)
Rruga "Mine Peza", Pallati 232
Shkalla 1, Apartamenti 14 Tiranë.

Reportazh

Mes shqiptarëve në Gjenova të Italisë: jeta e tyre e përditshme me hallet dhe problemet dhe malli për Shqipërinë

Mes emigrantësh shqiptarë në Gjenova

Nga: **SHAQIR SKARRA**



Avioni u ul me vonesë në aeroportin e Gjenovës. Megjithëse mbrëmja kishte rënë ne nuk na pengonte asgjë të vozitnim çdo gjë të mirë dhe të bukur në këtë qytet antik të Italisë veriore. Mbrëmja dhe avioni që po ulej ngadalë na lejonte që të hidhnim vështrimin cep më cep të qytetit. Fundja dhe qyteti shtrihej buzë detit dhe me sy shikonim fillimin dhe mbarimin e tij, një distancë kjo jo shumë e vogël. Gjenova shtrihej buzë detit dhe shkonte deri rrëzë kodrave të veshura me gjelbërim. Domosdo që dita e nesërme do të kishte dhe surpriza për ne pasi për herë të parë shkelnim tokën italiane dhe në një qytet antik verior të saj siç është Gjenova. Qëllimi i kësaj vizite nuk ishte takimi me emigrantët, por meqenëse erdhëm nuk mund të largoheshim pa u takuar shqiptarët që punojnë dhe jetojnë prej shumë vitesh këtu.

Pak histori

Edhe vetë gjenovezët e dinë historinë e qytetit të tyre antik por në fakt nuk duan që ta pranojnë. Nuk e pranojnë atë pjesë të historisë që lidhet drejt për drejtë me Shqipërinë dhe shqiptarët. Historia e migrimit të shqiptarëve në Gjenova është e vjetër, nuk është e vonë siç mundohen të shprehen shumë veta, qofshin këto dhe vetë shqiptarët të cilët nuk kanë njohuri mbi historinë e kombit të tyre. Me historinë e këtij migrimi të hershëm zë fill dhe vetë mbretëria gjenoveze. Vetë origjina e mbretërisë gjenoveze është e lidhur me Shqipërinë. Në vitet kur hordhitë turke po turreshin jo vetëm në ballkan por dhe jashtë tij njerëzit filluan të emigrojnë. Dhe jo vetëm nga pushtuesi por dhe nga besimi fetar që po përhapej nëpër Shqipëri. Një familje fisnike nga qyteti i Durrësit nuk mundi që ta pranonte besimin e ri ndaj një mëngjez u nis drejt brigjeve të Italisë. Fati e përplasi në Gjenova ku shumë shpejt pësoi fatin e keq që të ktheheshin në skllevër duke u shitur në një familje të mirë gjenoveze. Tregtia e mëparshme që kishte bërë kjo familje fisnike durrsake edhe në portet italiane shpejt ra në sy tek të huajt. Vetë pronari pas pak i fali lirinë kësaj familje me qëllim që të kontribonte sado pak për qytetin e Gjenovës. Fama që kishte patur andej nga erdhi, pasuria që kishte vënë me tregtinë e ndershme ia rritën më shumë vlerat familjes durrsake në qytetin e Gjenovës. Shumë shpejt do të hidhte bazat e para për të ngritur dhe konsoliduar mbretërinë gjenoveze e cila në ato vite ishte më e njohura në të gjithë Italinë. Pinjollët e kësaj familje janë sot në Gjenova ku dhe kanë bërë një studim lidhur me origjinën dhe kontributin që kanë dhënë në shekuj me radhë. Për hir të origjinës së tyre që vinin nga Durrësi ato e mbajtën për vite me radhë mbiemrin Durrazo. Sot jo vetëm toponimet por dhe mjaft godina funksionale të kthyera në muze janë të ndërtuar pikërisht nga kjo familje durrsake si pallati i mbretit, pallati i princit si dhe mjaft vila e ndërtesa të tjera pronë e kësaj familje.

Një kujtim i bukur mes dibranëve në Gjenova

Nuk e dinim se pikërisht në qytetin e bukur të Gjenovës prej vitesh punojnë e jetojnë mjaft emigrantë shqiptarë. Por ja që dhe në këtë qytet verior dibranët kishin numrin më të madh. E një natë më parë kur u ulëm në aeroportin e Gjenovës kishin dalë mjaft dibranë për të na pritur. Nesër në mëngjez telefonatën e parë e kisha me Shefki Matën. Ai erdhi me makinë në vendin ku isha akomoduar. Shefkiu, një djalë i ri e tepër energjik ka shumë vite në Gjenova. Është martuar me një vajzë simpatike gjenoveze, Emanuelën me të cilën ka dhe një djalë.

-Në fillim kemi vuajtur të gjithë, nis bisedën Shefkiu. Ishim pa letra dhe qëndronim të fshehur. Në punë të fshehur, në qytet rrallë dilnim, flinim ku të mundnim dhe kryesore punën e kishim të kufizuar. Sot krejt ndryshe. Jo vetëm unë por shumica e emigrantëve dibranë janë tashmë me letra të rregullta. Në punë janë me kontratë dhe sejcili ka shtëpinë e tij. Disa bile dhe kanë blerë shtëpi qoftë dhe nëpërmjet bankave të cilat ofrojnë kushte minimale për kredi. Shefkiu ishte vetë sipërmarrës ku kishte në punë dhe një grup të vogël specialistësh shqiptar, italianë e të kombësive të tjera.

-Ndoshta duke parë seriozitetin në punë më ka favorizuar vetë komuna e Gjenovës ku shumicën e objekteve për ristrukturim ma jep mua. Takimi me Shefkiun më krijoi mundësinë që të takoja dhe mjaft dibranë të tjerë që punonin në Gjenova.

-E shikon sa afër e kemi plazhin,- vazhdoi bisedën Shefkiu. Por pyet njëherë se sa ditë bëjmë plazh në vit . Jemi kaq të lidhur me punën sa që harrojmë dhe plazhin, fundja për këtë kemi ardhur këtu, kemi lënë dhe të afërmit, vendlindjen ku na këput malli por, eh ky fat u ra shqiptarëve, u derdhëm si zogjtë e korbit kudo nëpër botë.

Në darkë ishim mysafirë në shtëpinë e Shefkiut ku jo vetëm mes shqiptarëve por darka kaloi edhe me italianë, pse jo dhe një emigrantë nga Tunizia. Pas një darke të bukur mes emigrantëve të përmalluar për vendlindjen mëngjezi na gjeti pa gjumë.

Ishte e dielë dhe do të dilnim të shikonim më mirë qytetin.

-Sot do të takohemi me dibranë të tjerë, tha Shefkiu pasi të gjithë mblidhemi bashkë të dielave tek porti antik dhe ashtu bashkë nxjerrim mallin, na dukej vetja se jemi në Shqipëri. E vetmja ditë dhe i vetmi vend që flitet shqip.

Makina pas pak ndaloi. Një zallamahi e madhe njerëzish ecte e shkujdesur bregut detit. Kishte kombësi të ndryshme si maroken, kinez, rumun pse jo dhe afrikanë etj. Këtu vërtet ishte një copë Shqipëri. Mjaft kinez, maroken por dhe afrikanë shisnin në rrugë, pa tezgë por në tokë tamam si në Shqipëri. Shqiptarët dalloheshin nga të gjithë pasi rrinin bashkë.

Një anije e madhe prej druri tërhiqte njerëzit për të bërë fotografi. Kjo ishte anije muze me të cilën kishin xhiruar dhe mjaft filma artistik ndaj me të drejtë quhej porti antik. Flitej se këtë anije ia kishte falur mbretëresha e Spanjës, mbretit të Gjenovës Durrazos. Dhe Shefkiu nuk më kishte gënjyer. Këtu takuam mjaft dibranë që kishin vite që banonin dhe punonin në Gjenova. I gjetëm të gjithë bashkë në një lokal të vogël buzë detit por dhe duke bërë fotografi tek anija e drurit. Të tjerë ishin futur duke vizituar akuariumin, më të madhin në të gjithë Europën.

Albert Rama ishte nga Melani dhe kishte më shumë se dhjetë vjet që punonte këtu.

-Tashmë do të punoj dhe pak sa të arsimoi fëmijët pasi i kam në shkollë . Pastaj do të kthehem në vendin tim, me ato pak lek që kam fituar do të kthem në Shqipëri e do t'i kthehem punës. Ndoshta do të krijoj ndonjë pemtore në fshat pasi gjithë fshatarët i janë kthyer traditës në Dibër duke ngritur plantacione me pemtore.

Duke qëndruar kështu bashkë mes emigrantëve dibranë, mbrëmja erdhi shpejt. Për darkë ishim tek Urimi, vëllai i Shefkiut, i cili kishte blerë dhe shtëpi në Gjenova dhe jetonte njësoi si italianët që kishin një jetë të tërë në këtë qytet.

-Dikur po, kemi vuajtur majft, - tha Urimi. Edhe në punë dilnim me dit pasi kishim frikë nga policia, edhe për të fjetur strehoheshim ku të mundnim. Sot jo, jemi krejt ndryshe. Njësoj si italianët. Këtu nuk ka racizëm si në Greqi. Dalim me shokë por dhe me familje, hamë ndonjë darkë jashtë, bëjmë plazh kur kemi pushime, bëjmë pazarin, kthejmë vizita tek njëri tjetri. Shkurt asgjë nuk na mungon. Vetëm malli për vendlindjen na mungon shumë. Na mungon një copë Shqipëri, na mungon aq shumë saqë vetëm kur mblidhemi tok bashkë na duket sikur vërtet çmallemi pak. Komuniteti shqiptar këtu në Gjenova është shumë i bashkuar. Jemi bashkë në gëzime dhe hidhërime. Kur para disa vitesh na u vra një dibranë të gjithë dhamë kontribute për ta nisur kufomën në Shqipëri. Jo vetëm kaq por në vendin që u vra kemi vendosur një pllakat mermeri dhe sa herë kalojmë andej ndalojmë e vendosim lule. Bota e emigrantit është e madhe nis e flet Urimi, aq e madhe sa po ta njohësh mirë atë do të kuptosh se megjithëëse këtu sot nuk na mungon asgjë, malli është i madh, aq i madh saqë po na zhurit shpirtin.

-Jemi në dhe të huaj bre, futet në bisedë Shahin Ajazi nga Lura. Vërtet që jemi të bashkuar këtu por kur rri vetëm dhe kujtoi Lurën time lotët më



Pamje nga Gjenova

tradhëtojnë shpesh herë. Në Milano, Romë, Firence apo dhe në jug të Italisë emigrantët janë më të organizuar. Kanë ngritur shoqatë por kanë dhe gazetë në gjuhën shqipe, e kjo nuk është pak për emigrantët që jetojnë e punojnë jashtë vendit. Ato po, janë vërtet një zë i bashkuar për të kërkuar të drejtat e tyre, protestojnë nëpërmjet shtypit dhe mediave të ndryshme. Kurse këtu tek ne ende jemi larg kësaj ideje. Megjithëse kemi dhe mjaft studentë shqiptarë që studiojnë këtu, kemi emigrantë të arsimuar ende nuk kemi mundur të organizohemi mirë. Atëherë po, them me bindje se do të bëhemi faktor në këtë qytet të bukur që jetojmë e punojmë prej vitesh.

Një dasëm shqiptare

E diela tjetër i gjeti përsëri dibranët bashkë por jo më tek porti antik. Në mëngjez herët kishin dalë të veshur bukur dhe prisnin tek komuna. Pikërisht këtu do të celebrohej dhe martesa e vajzës simpatike dibrane Elizabeta me Luca Talaricon një djalë gjenovez. Pas celebrimit të gjithë së bashku hipur nëpër makina kaluam Gjenovën dhe vajtëm në një lokal të bukur në një zonë mjaft piktoreske. Këtu vetëm guzhina ishte italiane dhe me gatime karakteristike gjenoveze. Çdo gjë tjetër ishte shqiptare. Që nga nusja e bukur dhe simpatike, fustani i bardhë, të ftuarit e shumtë e deri tek tortat të jepnin të kuptoje se po bëhej një dasëm në Shqipëri dhe jo në Itali. Pas banketit që zgjati gjatë erdhi radha e muzikës ku të ftuarit do të ngjiteshin në katin e dytë që të kërcenin dhe këndonin. Këtu dasma u ndez falë këngëve e valleve shqiptare. Ishin vetë të ftuarit dibranë që kishin pregaditur muzikë popullore shqiptare e cila jehonte edhe jashtë lokalit. Në valle bashkë me nusen e dhëndrin u ngritën të gjithë të ftuarit shqiptarë e italianë kërcyen së bashku . Makinat ndaluan në rrugë për një çast dhe dëgjonin muzikën e bukur shqiptare e cila po jehonte ndoshta për herë të parë në atë zonë piktoreske të Italisë.

-Të trashëgohesh Elizabeta! Qofshë e lumtur! Qofsh e bardhë siç je! Na bashkove sonte të gjithëve, na bëre bashkë, na nxorre mallin e vendit tonë. Kishim kohë që nuk kishim gëzuar kështu shqip. Të gjithë këto urime buronin nga zemra e dibranëve të cilët ishin të pranishëm në këtë gëzim.

-Kjo është dasma e të gjithve, thoshte Iljazi pasi dhe Elizabeta është motra e të gjithve. Kështu shprehet edhe Shahini, Alberti, Urimi, Albani e Shefkiu. Kështu shprehen dhe nuset e tyre të cilat ishin më të ndjeshme pasi kishin kohë që nuk kishin marrë pjesë në një gëzim të tillë.

-Edhe po të ishim në Shqipëri besoj se nuk do të bëhej më mirë kjo dasëm, thotë Lindita, gruaja e Urimit. Për pak çaste u çmallëm vërtet, u çmallëm me njëri tjetrin, u çmallëm me muzikë e valle shqiptare. Makinat në rrugë filluan të rrallohen dhe ne atëherë e kuptuam se po gdhinte mëngjezi. U nisëm përsëri drejt Gjenovës ashtu siç kishim ardhur. Çifti në një makinë të hapur dhe ne autokolonë me makina nga pas. Erdhi përsëri mbrëmja. Ditët e qëndrimit në Gjenova kaluan shpejt. Në aeroport kishin dalë përsëri të gjithë të afërm e emigrantë dibranë. Një kafe dhe një fotografi të fundit bashkë e me çanta në duar u nisëm. Ktheva edhe njëherë kokën pas dhe pashë mjaft sy të përlotur. Eh, thashë me vete. Jetë emigrantësh. Sa shumë u mungon vendlindja. Nejse ky është fati i shqiptarit. Avioni u nis përsëri me vonesë. Fundja Tirana vetëm një orë e tridhjet minuta është larg me Gjenovën. U përhumba paksa në botën e emigrantëve me të cilët qëndrova plot dy javë por u zgjova shpejt. Pasagjerët filuan të marrin çantat. Kishim arritur në Rinas.

Në vështrim mbi lidhjen e Dibrës dhe bijëve të saj në emigracion. Si funksionon lidhja dhe rrugët e mundësitë për më shumë investime, që do ti japin hapsirë zhvillimit të vendlindjes

DIBRA E MADHE - INDIFERENTIZMI I MËRGATËS DIBRANE

Dibranët lypin investime e jo fjalë boshe



Dibra e Madhe

NGA **REXHEP TORTE**

Edhe kësaj vere në Dibër të Madhe erdhën mërgimtarët. Kësaj vere erdhën afër tre mijë mërgimtarë, më pak se sa viteve tjera.

Ardhja e mërgimtarëve në Dibër të Madhe ka shumë qëllime sublime. E para është çmallja me prindërit, të afërmit, miqtë, shokët e shoqet. E dyta synetet, fejesat e dasmat caktohen gjatë pushimeve verore për të krijuar mundësinë që këto çaste gëzimi t'i kalojnë sëbashku mërgimtarët dhe dibranët që jetojnë në vendlindje. Vendasit dhe mërgimtarët gjatë pushimeve krijojnë mundësi që të rinjtë të njoftohen, të krijojnë lidhje fejesash e martesash, me të vetmin qëllim për t'i ikur asimilimit në vendet e huaja, e që maksimalisht të krijohen lidhje e miqësi mes vetë dibranëve, për t'i ruajtur aqë sa ka mundësi traditën, doket e mentalitetin dibran.

Mërgata t'i vë dorën Dibrës së Madhe

Sipas treguesve flitet se në SHBA ka afër 15 mijë dibranë. Dibranë ka edhe në Kanada, në shtetet e tjera të Evropës e gjer në Australinë e largët, por numerikisht më pak.

Një pjesë e konsiderueshme e mërgatës dibrane ka veprimtari dhe biznese tejet të suksesshme. Flitet se pasuria e tyre vlerësohet në miliona e miliona dollarë, ndërkaq sasi të mëdha parashë janë depozituar edhe në bankat ku jetojnë e punojnë.

Megjithatë investimi i dibranëve në vendlindje është pothuajse zero. Kjo ndikon që për shkak të papunësisë së theksuar dita ditës nga Dibra e Madhe të largohen të rinjtë, të cilët këtu nuk shohin asnjë perspektivë për jetën dhe ardhmërinë e tyre. Çdo e treta shtëpi është e mbyllur me çelws dhe hapet vetëm kur mërgimtarët vijnë për pushime.

Nuk ka mërgimtar dibran që nuk thotë se e don vendlindjen, se e don Dibrën, por kjo më shumë bëhet deklarativisht, sa për t'ia bërë qejfin vetes dhe atyre me të cilët flasin, se sa financiarisht për të ngritur ekonomi të vogla apo të mesme dhe për të zgjeruar frontet e punës.

Pasiviteti i mërgatës dibrane u tregua edhe gjatë periudhës së privatizimit në vendlindjen e tyre dhe asnjëri nuk u bë i gjallë që të venw dorë dhe të aktivizojë ndonjërin nga objektet ekonomike të falimentuara. Kjo ndodhi edhe me fabrikën e dëgjuar të qilimave, ku dikur punonin afër 1 mijë punëtorë e punëtore, ndërsa sot është rrafshuar për toke, ka ndërruar destinimin dhe nuk gjendet asnjë gjurmë e saj.

Dibrën e Madhe e kanë ruajtur dhe e ruajnë ata që jetojnë dhe sfidojnë vazhdimisht. Dibranët nuk lypin lëmoshë dhe të gjithë e dijnë se rrugëve të Dibrës së Madhe nuk ka lypësa dibranë. Lypsat që i takon rrugëve të Dibrës së Madhe janë të ardhur klandestinë.

Dibranët kanë sedrën dhe dinjitetin e tyre. Ata kërkojnë të kenë ku të punojnë dhe me djersën e ballit ta fitojnë kafshatën e bukës dhe të krijojnë ardhmërinë e tyre. Mërgata dibrane ka dështuar në investimin dhe krijimin e ndërmarrjeve të vogla, të mesme, apo në ngritjen e plantacioneve bujqësore, për të cilat ekzistojnë kushte dhe mundësi. Kështu do të punësoheshin dibranët dhe me punën e tyre të vyer do të kishin leverdi të ndërsjellë edhe pronarët e ndërmarrjeve edhe punëtorët. Kështu më së miri do të zhvillohej dhe mbrohej Dibra e Madhe nga boshatisja dhe nga kolapsi ekonomik që e ka kapluar. Këtu duhet përqëndruar vëmendja e mërgatës dibrane.

Dibranët po i sfidojnë kohës

Vitaliteti i pamohueshëm i shqiptarëve më së miri dëshmohet nëpërmjet dibranëve, që karakterizohen përmes tre Dibrave. E para- Dibra e Madhe dhe kryeqendra e Krahinës së Dibrës deri në vitin 1913, kur me Konferencën e ambasadorëve në Londër në vitin 1913 dhe me Konferencën e Paqes në Paris 1919-20, iu dhurua Beogradit dhe sot ndodhet në Maqedoni. E dyta- Dibra e Vogël-Peshkopia , e cila mbeti në Shqipëri, dhe e treta një Dibër e tërë e mërgimtarëve që tashmë gjendet në SHBA.

Çdo pëllëmbë toke e Dibrës së Madhe është e larë me gjakun trimëror të burrave e grave për të mbrojtur nderin, veten, fëmijët dhe pragun e shtëpisë. Edhe pse e shkatërruar, e kafshuar, e tradhëtuar dhe e djegur shumë herë gjatë shekujve, Dibra me njerëzit e saj gjithnjë kanë gjetur mundësinë të sfidojnë e të hedhin shtat, sikur lisi në pyll të shkrumuar.

Serbët Krahinën e Dibrës e kanë djegur tri herë, duke detyruar shpërnguljen e dhjetëra mijërave dibranë. Ata kanë djegur shtëpitë sëbashku me fëmijët dhe pleqtë brenda, kanë vrarë njerëzit e pafajshëm në oborrin e shtëpisë, kanë përdhunuar, kanë grabitur tërë pasurinë dhe gjënë e gjallë, për të mos lënë asnjë kusht për vazhdimin e jetës. Gjatë vendosjes së kufirit në Dibër të Made nuk u përfill as konfiguracioni natyror dhe as as vullneti politik i dibranëve. Shkrimtarja amerikane Rous Uajder Lein në vitet e 20-ta të shekullit 20-të, në librin e saj "Majat e Shalës", shkruan se "Qyteti i Dibrës iu muar Shqipërisë me vijën kufitare të vitit 1913, siç nxirret sythi i një patateje". Ndërkaq Dimitrije Tucoviq në librin " Serbia dhe Shqipëria", duke përshkruar gjendjen e krijuar në viset e aneksuara nga Serbia, thotë se, "aneksimi ndau bujkun prej arës, bagëtinë prej kullotës, tufën prej lugjeve, fshatin prej mullirit, blerësin dhe shitësin nga tregu, rrethin prej qytetit dhe tërë viset malore prej qendrës së tyre ekonomike e hambarët e ushqimit... burimet e jetës u prenë". Ndarja e Dibrës në dy pjesë, është kobi më i madh që ra mbi Dibrën e Madhe dhe që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Pas luftës së Dytë Botërore bijtë më të mirë dibranë u bënë pre e përndjekjeve, burgosjeve dhe vrasjeve më mizore të UDB-së serbomaqedonase. Atdhetari Nexhat Agollijurist i diplomuar në Romë, zv/kryeministër dhe ministër i Asistencës sociale në Qeverinë e parë të Maqedonisë, u burgos dhe u torturua për vdekje në vitin 1949. Xhafer Kodra, ministër i Drejtësisë së Maqedonisë, u arrestua gjithashtu në vitin 1949 dhe kthehet i dërmuar psikikisht dhe fizikisht nga torturat në Goli Otok, etj.

Në Dibër të Madhe shteti ka investuar pak

Gjatë sistemit gjysëmshekullor monist investimet për zhvillimin ekonomik të Dibrës së Madhe ishin shumë më të pakta se në vendet e tjera. Edhe sot e kësaj dite shteti nuk e ka në sy të mirë Dibrën e madhe dhe investon shumë pak.

Ndarjet e njëpasnjëshme territoriale kanë bërë që sot Dibra e Madhe të mbetet me sipërfaqe prej 180 mijë kilometra katrorë dhe afër 19 mijë banorë.

Investuesit që kanë mbetur në histori

Në bëmat historike të Dibrës së madhe ka shumë dibranë, të cilët ishin donatorë të shumë ngjarjeve dhe që për çështjen kombëtare shqiptare shkrinë tërë pasurinë dhe jetën e tyre.

Fuad Dibra, patrioti dibran e mbarëshqiptar, refuzoi tërë ofiqet mashtruese, dhe për çështjen kombëtare shqiptare shkriu tërë pasurinë dhe jetën e tij. Ai në Konferencën e Paqes në Paris më 1919-1920, ku u arrit që Shqipëria të njihet si shtet i pavarur, harxhoi më shumë se 500 mijë franga ari, duke financuar qëndrimin dhe veprimtarinë e delegacionit shqiptar në këtë konferencë vendimarëse.

Ismail Pashë Dibra, ishte donatori kryesor i mbajtjes së Kongresit të Manastirit. Hoxhë Maliq Tanusha, ishte donator për hapjen e shkollave shqipe në trojet shqiptare etj.

Ata që mirëfilli e duan Dibrën e Madhe duhet edhe të investojnë.

DIBËR E MADHE - SHOQATA QYTETARE "VOTRA DIBRANE"

Mirënjohje mërgimtarit Rexhep Erbeli



Rexhep Erbeli

Shoqata Qytetare "Votra Dibrane"-Dibër e Madhe , më 6 gusht 2008, në Qendrën kulturore organizoi një takim mirëseardhës për nder të mërgimtarit aktivist dibran Rexhep Erbeli, i cili aktualisht jeton në SHBA.

Shpëtim Cami, kryetar i SH.Q. "Votra Dibrane", para të pranishëmve, theksoi se "Rexhep Erbeli dhe bashkëshortja e tij Lirije pas tridhjetë vite jetë në mërgim kanë ardhur këtyre ditëve që në mesin tonë t'i ndajnë emocionet e përmallimit. Me këtë rast përshëndesim të gjithë mërgimtarët tanë kudo që ndodhen duke uruar mbarësi dhe rikthim më të shpejtë në vendlindjen që i pret krahëhapur. Shoqata jonë në veprimtarinë saj ka përcaktuar edhe aktivitetet rreth vlerave dhe të arriturave të qytetarëve tanë këtu dhe në mërgim, në lëmin e ekonomisë, shkencës, arsimit, kulturës dhe artit. Rexhep Erbeli në këtë takim vjen si triumfues ndaj sfidave të shumta në SHBA, atje ku lidhen e zgjidhen fatet e njerëzve e kombeve, sepse ishte zë i fuqishëm i çështjes sonë kombëtare", tha Cami.

Ai tha se Rexhep Erbeli, atje mori pjesë dhe u printe protestave të shumta, kontakteve e lobimeve me faktorët vendimarrës, për të kërkuar të drejtat shqiptare, lirinë e pavarësinë.

"Në të gjitha këto rrjedha dera e shtëpisë së tij nuk u mbyll asnjëherë. Ajo ishte e hapur edhe për hallexhinjtë dhe kërkesat e bashkëkombasve. Ai i mirpriste dhe i orientonte personat e njohur të politikës, artit e kulturës që arrinin atje për të mbrojtur interesat shqiptare", tha ai.

Shehat Marku, ish kryetar i Shoqatës, shtoi se, "Rexhep Erbeli ka fituar të drejtën qytetare që me vlerësimin si njeri i dashur dhe i përkushtuar për bëmirje të dibranëve të mërguar në SHBA.

"Bëmat pozitive të njerëzve bëhen leva bartëse për të shembëllyer ndër breza. Rexhep Erbeli në këtë kuptim themeloi individualitetin përmes urtësisë, njeriut të respektuar kolektivisht për vlerat e bamirësisë, duke prodhuar rezultate shembullore për shtytjen e proceseve në kohë dhe hapësirë. Ai është edhe themeluesi i Shoqatës Atdhetare Dibrane në SHBA", tha Marku.

Në emër të Sh.Q. "Vorta Dibrane" Rexhep Erbelit iu dorëzua Mirënjohje për merita të veçanta në integrimin e suksesshëm të bashkëqytetarëve tanë në jetën dhe veprimtarinë e tyre në SHBA, lobimin e frytshëm në SHBA të çështjes aktuale shqiptare në tërësi, për vepra bëmirëse ndaj shqiptarëve në SHBA, vendlindje dhe më gjerë, për kontribute të veçanta në themelimin dhe afirmimin e aktivistëve të Shoqatës "Votra Dibrane" në Dibër.

Rexhep Erbeli duke u falenderuar, para të pranishëmve deklaroi se: "Mirënjohjet e këtilla as nuk shiten e as nuk blihen, ato janë shprehje e një vlerësimi njerëzor nga zemra e pastër dibrane".

Rexhep TORTE

esse

Një lexim ndryshe i Umberto Eco-s.
Udhëtimi i tij në Rusi dhe keqinformimi për Shqipërinë.
Reagimi intelektual për të vërtetën

Si e shpalli "persona nongrata" U. Econ pushteti ynë i djathtë



Nga: AGRON TUFA

Ka qenë qershori i vitit 2000 kur Umberto Eco erdhi i ftuar për një kurs leksionesh mbi semiotikën, në Institutin e Kulturave Europiane të Moskës, ku studioja edhe unë asokohe - i vetmi student shqiptar aty. Në fund të javës qenë vënë afishet në të gjitha ambientet e Universitetit të Shkencave Humanitare se të shtunën, mjeshtri i madh, shkencëtari i famshëm dhe prozatori lavdishëm i postmodernizmit do të jepte një konferencë shtypi. Në mbarë botën letrare, universitare e shkencore të Moskës ky ishte një "peshk i madh" për kurreshtjen e elitës, duke pasë parasysh dhe faktin që Umberto Eco ishte gjerësisht i njohur dhe i lexuar në Rusi. E shtuna e shumëpritur erdhi. Në orën 11.30' salla e madhe e konferencave të Universitetit qe mbushur cit dhe rrëketë e njerëzisë që mësynin dyert e sallës u mpiksën aq keq, sa mbeten të ngrira e të palëvizshme, pa asnjë mundësi tjetër për qenë të pranishëm brenda, andaj u sajua një lidhje me qendër zëri, që ta ndiqnin bisedën nga ambientet e jashtme, pa e prekur, ajme, me sy, aurën e gjallë të idhullit të tyre.

Dikur, më vështirësi të mëdha, i rrethuar nga një gardh profesorësh rusë dhe amazonkash që ngjanin më shumë me gardianë, ia behu edhe Eco. Për një kohë të gjatë i buzëqeshi vesh me vesh sallës në delir dhe ovacione, mandej zuri vend në qendër të një tavoline të gjatë, të mbushur me një rradhë mikrofonash dhe vazo të mëdha lulesh. Ishte një zagushi e madhe, djersë e ufëm, por edhe qafa të tendosur që zgjateshin të shihnin fytyrën më të zgjuar mjekëroshe të planetit, që thuajse kishte humbur pas shkurreve të lulëzuara në tavolinë. Dukej e zhdukej vetëm vizllimi i reflekseve prej syzeve të tij tek shpërndanin mendjemprehtësi dhe inteligjencë spekulative, çka u sillte adhurueve mahni, respekt e përulje. Dikur edhe Eco u kështillua me dy përkthyeset amazona, të cilat nxituan të zhdavarisnin retë e dendura të luleve. Kësodore u shpalua i qartë torsi simpatik i njeriut të madh. Dhe mjeshtri foli. Në sallë ra heshtja përdëllyese. Isha në rradhët e para dhe e ndiqja pa vështirësi ligjërimin e tij gjithë batuta të kripura mbi formalizmin rus, strukturalizmin dhe semiotikën, ndërsa në ije, ndjeja herë pas here godidjen e lehtë me bërryl të poetit Danjilla Davidov, krejt të përpirë nga adhurimi (një ditë më pas ai më dha dhe një poezi të shkruar posaçëm me atë rast).

Por nuk dua të ndalem në aftësitë oratorike të mjeshtrit të madh. Ai i hipnotizoi dëgjuesit me erudicion, gjetje origjinale plot xixëllima mençurie e sidomos humor të zgjuar paradoksal. Më intereson të kujtoj pjesën e nxehtë të përgjigjeve të tij për pyetjet e panumërta që i bëheshin nga salla.

Ja, në njërën prej pyetjeve do të ndalem dhe për faktin se atë pyetje e formuloi miku im poet, Danjilla Davidovi, që siç e kemi thënë, e kisha përbri:

- Mjeshtër, siç është gjerësisht e njohur, ju jeni një ndër personalitetet më ndikuese të inteligjencies europiane që, personalisht, i përmbaheni pikëpamjeve politike të majta. A ju ka ndodhur mjeshtër, që pikërisht për shkak të këtyre bindjeve, ose frymës së këtyre bindjeve, të jeni ndjerë i padëshirueshëm në ndonjë ambient, lëvizje intelektuale në Itali, apo kund tjetër gjetkë?

Pasoi një heshtje gjersa njëra prej amazonave përkthyese ia përcolli pyetjen të plotë rrëzë veshit, ndërkaq që Eco, me kokë të anuar, nuk ia ndante sytë atij që kishte bërë pyetjen, teksa tundte ritmikisht kokën e anuar. Mori drejtqendrimin dhe shpalli:

- Faleminderit për këtë pyetje kaq interesante... a e dini çfarë, zotëri simpatik? Jo... jo, më falni më parë t'ju pyes: ju vetë, çfarë pikëpamjesh ndani?... nëse, sigurisht, nuk përbën ndonjë sekret...

- Politike? - kërkoi të sqarohej miku im.

- O, sigurisht... për atë po flasim...

- E qartë. Ju siguroj, i nderuar mjeshtër, asnjë sekret s'ka dhe, nëse më lejoni, bindjet e mia të deritashme janë të djathta, e... në pastë gjë tjetër të rëndësishme, është fakti se këto pikëpamje, po të shprehemi figurativisht, i kam farkëtuar vetë në kudhrën e realitetit tonë.

- Ju kuptova dhe, as që e vë në dyshim përgjegjësinë e kërkimit tuaj intelektual, që ju ka sjëllë, me ndërgjgje të lirë, në pikëpamjet tuaja të djathta. Por që të mos i shmangemi pyetjes suaj në fillim, po ju rrëfej një rast të dhunshëm arrogance politike që më ka ngjarë në Shqipëri.

Përveç habisë sime, ndjeva edhe bërrylin e fortë të Davidovit në ije.

- Ka ngjarë kështu, - vazhdoi rrëfimin Umberto Eco. - Në pranverën e vitit 1993, përkthyesja ime dhe një grup intelektualësh shqiptarë më ftuan në Tiranë me rastin e promovimit të romanit tim "Emri i trëndafilit". Por sa zbrita në Durrës, pushteti i atëhershëm i djathtë, i partisë Demokratike shqiptare, më ndaloi dhe më ktheu mbrapsht si "persona nongrata" për shkak të bindjeve të mia të majta, pa arritur të kontaktoj dot me grupin e intelektualëve shqiptarë që, sipas fjalës, kishin dalë të më prisnin.

Ndërsa kishte ndërhyrë pyetja tjetër, ashtu i turbulluar nga ky informacion negativ, u rreka të kthjellohem në disa mospërputhje dhe, sapo mbaroi përgjigjen, unë tashmë e kisha ngritur dorën, derisa m'u dha fjala.

- I nderuar mjeshtër, a jeni i sigurtë se ky incident i papëlqyeshëm me Shqipërinë ju ka ndodhur në pranverën e vitit 1993?

- Po, po, për këtë ju siguroj... është një fakt i veçantë që nuk mund ta ngatërroj lehtë.

- Atëherë, mjeshtër, kam përshtypjen se logjika juaj ka një plasaritje të fortë dhe nuk përputhet me faktet...

- Continua a raccontare, prego...

- Sepse, mjeshtër, në vitin 1993, me sa di unë, ju keni botuar në Shqipëri vetëm një ese me titull "Tregëtarët e apokalipsit", në gazetën "Zëri i Rinisë".

Umberto Eco ngriti të dyja duart lart në shenjë të thellë habie dhe, më shumë se mua, iu drejtua publikut:

- Si duket, po përballemi me një rekord të skrupulozitetit bibliografik! - tha dhe shtriu dorën me xhentilesë drejt meje, për të më lënë të vazhdoja.

- Jo, i nderuar mjeshtër, është një ese që s'e kam merituar ndonjëherë... thjesht këtu jam një student shqiptar dhe, asokohe, në vjeshtë 1993 kur është botuar eseja juaj, kam qenë redaktor i kësaj gazete. Ndërsa promovimi i romanit tuaj, për të cilin thatë se ju ftuan më 1993, nuk mund të ndodhte para se të përkthehej. Dhe siç e dimë mirë të dy, "Emri i trëndafilit" është botuar më 1998; atëherë pra, kishte vend t'ju ftonin në promovimin e tij, nëse një ftesë e tillë ju është bërë... Mirëpo, edhe sikur t'jua kishin bërë një ftesë të tillë në Shqipëri (dhe kjo do të kishte vend vetëm në vitin 1998, jo më parë), prapë na del një mospërputhje e madhe, tashmë e një natyre thelbësore: atëherë në pushtet nuk ka qenë e djathta, që t'ju kthente mbrapsht si "persona nongrata", për shkak të bindjeve tuaja të majta. Përkundrazi, që nga viti 1997 e deri tani që po flasim, Shqipërinë e qeveris pushteti i së majtës. Ata duhet t'ju kishin dëbuar për shkaqe bindjesh të majta. Po përse ta bënin këtë? Për shkak të bindjeve tuaja të majta? Kjo do të ishte një oksymoron! Prandaj ju thashë se logjika juaj bart një plasaritje të thellë, trashësia e së cilës shkon plot pesë vjet distancë. Me çfarë logjike ta mbushim këtë thellomë, i dashur mjeshtër?

Gjatë gjithë asaj kohe kishte zotëruar një bunacë heshtjeje, por me të mbaruar pyetjen salla u përmbyt nga mërmërima të sikletshme pakënaqësie, që për mua kishin një domethënie të padyshimtë: "ja tani dhe ky shqiptar mistrec vjen e na prish festën!".

- Epo, si duket, të nderuar kolegë, - iu drejtua Eko, tashmë sallës, jo mua, - qenka dashur të udhëtoj gjer në Moskë për të dyshuar në besnikërinë e kujtesës sime... eh... njëherë tjetër do t'i japë një përgjigje më të përpiktë kolegut tuaj shqiptar... pa harruar ta falendoroj për një të dhënë me interes të madh për mua, si botimin tim të parë në Shqipëri të esesë "Tregëtarët e apokalipsit"... - deshi ta mbyllte situatën diskomforte, por ndërkohë ishte ngritur në këmbë Danjilla Davidovi:

- Mos ndoshta mjeshtri i madh e ngatërron përvojën nga Shqipëria me ndonjë vend tjetër?

- Ndoshta, ndoshta... nuk e përjashtoj edhe këtë mundësi...

- Ju lutem shumë, - gjëmoi pizgë një zë nervoz prej femre, - ju vajzave moderatore! Mos e drejtoni diskursin në qorrsokaqe të tilla dhe... më falni... në çështje pa pikë interesi për ne... Sepse, më falni, mjeshtrin nuk e kemi ftuar t'i japë hesap kujt!

Pas apelit të saj, salla u shkund dhe dialogu me Ekon rinisi, i ngrohtë, i gjallë, hokatar, me pyetje të rafinuara për çështje të mëdha e, natyrisht, me përgjigjie të zgjuara që i shkojnë për shtat klasit të tij.

DANJILLA DAVIDOV

LEKSIONI I UMBERTO EKOS NË MGU

Ne e pamë, ne erdhëm dhe e gjetëm.
O. Mandelshtam

Mjedis i ngrohtë pritjeje për mysafirin e shtrenjtë,
më saktë, zagushi. Në "Telegraf" - një intervistë e tij
pas RGGU-së. Atje gjithashtu kishte mbajtur një farë leksioni,
ku kishin qenë dhe Svjeta e Goni.

Goni mandej na tha se, burrë i rëndomtë qe, barkalec,
por simpatik, siç bën vaki jo rrallë. Por, tha Svjeta, përgjigjjet -
të zgjuara ama e me peshë. Zumë vend ndanë dritares,
sekush prej nesh mbante një ritëm me këmbë, një zot e di pse.

Ambient zagushitës. Gjysëm ore para fillimit
mbërriti pikun. Studentë e aspirantë djersijnë,
disa u lëshojnë vendet profesorëve të dashur,
e ata të prekur ua kthejnë: "Para gjenive të gjithë janë të barabartë".

Njëzet minuta para fillimit largohen disa.
Disa deshën të bien pa ndjenja, por, ajme,
as gjilpërën s'ke ku e hedh, jo më vashat gjinjmëdha,
një metër e tetëdhjetë, nëse nuk zgjaten majë gishtash.

Shpejt mbijnë para sysh Vedenjapini me Prokopjevin. I salutoj.
Ka dhe të njohur të tjerë nga të departamentit,
Gollovanovi, Lovshini, Veronika Bodje,
Vasja kuznjecov dhe nja dy-tre të tjerë.

Pesë minuta para fillimit (vonesa është e pashmangshme).
Dikush nxjerr diktofonët, fotoaparatët.
Lum kush ka zënë vend në parvaze dritaresh. Ata të Humanitares
s'e kanë parë këtë vaki. Gjithkund tabela me sheigjeta: Eco".

Katjes po i merret fryma, bën të largohet,
por sheh Koreckin dhe i avitet pranë.
Shpejt do të gjëmojë auditori, pështjellime,
tik nervor, drithërima, mahni e përgjithshmë: "Eco".

Tashmë mund ta dallosh, teksa zë vend në poltrona
(para një minute një koreane e lëshuan gjunjët).
Tani më nuk ndjehet ufma. Tani më s'është aq ngushtë.
Ai po flet. Italisht dhe anglisht. I mençur e mendjehollë.

Herë flet e herë lexon (më shumë lexon),
e përkthen Katja Kostjukoviç që ka përkthyer "Emri i trëndafilit".
Duhej të kisha ardhur dy orë përpara,
që afër gjeniut të uleshe. Kështu e kanë këto punë.

E ai lexon leksionin. Flet për gjithfarë paragjykimesh.
Që gjithmonë na kanë premtuar se fiton ky e fiton ai, por ja
falë një farë gjëje të që s'ta pret mendja
kompjuteri nuk do ta varrosë librin, madje do ndoshë e kundërta.

Rruga e drejtë nga Gutenbergu deri tek Interneti - asfarë ndryshimi
mes sosh nuk ka. E gjithësesi ndryshime prapë ekzistion,
por, si ndryshimi ndërmjet botëkuptimeve të Robinsonit dhe Premtit,
çka nuk përbën asfarë tragjike.

Ka, menjëmend, një rrezik, që imazhet do ta mundin shenjën.
Ka mundësi, me gjasë, që njerëzimi të ndahet në dy klasa:
ata që do të lexojnë në një mënyrë, dhe të tjerë që do të lexojnë
ndryshe. Pra, që nuk do të lexojnë fare. Dhe kjo do të jetë masa,

ndërsa te të parët, do jenë intelektualët. Në jetë të jetëve.
Hë pra (duke iu kthyer sallës), sigurisht, për ne këtu është fjala.
Duartrokitje, të qeshura. Grepi për budallenjtë
u largua, të gjithë i dërgojnë të puthura.

Tirani simpatish. Dy-tre shaka.
Autografe për ata që e mbërthyen.
Në koridor ndesha ?.N.Shçupllovin me një djalosh,
dhe më duket, Olja Snjejkën.

Ç'paske dalë, më tha, të dëgjosh Eco-n,
po, ia qëllove drejt, po ti, edhe unë,
nejse, paçim, paçim. Bleva një lëng molle.
Ah, ja dhe Koreckij me Katjen, po vijnë kundruall.

Banjat e Dibrës, Banjishti dhe Kosovrasti.
Si funksionon dhe si rritet çdo ditë biznesi i
ujrave termale dhe shërbimet për publikun

BANJAT E DIBRËS SË MADHE-CAPA

Aty ku bashkohet mrekullia dhe pasioni njerëzor

Dibrës së Madhe natyra ia ka dhuruar ujërat termominerale në lokalitetet e Banishtit dhe të Kosovrastit. Përbërja e pasur kimike dhe radioaktive e ujërave, karakteristikat e tyre mjekuese të shoqëruara me klimën e përshtatshme dhe ambientin e bukur, jënë bërë joshëse për shumë vizitorë, te cilët vijnë për të shëruar sëmundje të ndryshme, por edhe për të pushuar dhe për tu çlodhur psikikisht.Sivjet pritet të arrihet rekordi prej 65 mijë buajtjesh.



Mexhit Capa - pronar i Banjave te Dibres



Banja e Banjishtit

Banja me spektër të gjerë mjekimi

Përbërja termominerale e ujërave dhe veprimi shërues i këtyre banjave, i radhit ato në më të njohura në botë.

Sipas institutit AKAO të Zvicrës që merret me studimin e banjave termominerale, ujërat e Banjave të Dibrës së Madhe-Capa kanë një kompleksitet të përbërjes kimike, të squfurit, radioaktivitetit, të mineraleve të ralla e të gazrave zbërthyese, që i bëjnë të jenë më efektive në kurimin e shumë sëmundjeve.

Efekti më i sukseshëm i ujit termomineral të Banjave të Dibrës së Madhe-Capa arrihet te sëmundjet reumatike, të aparatit lokomotor,



Banja e Kosovrastit

te sëmundjet e organeve gastrointestiale, te sëmundjet e organeve respiratore, te sëmundjet e sistemit kardiovaskular, te sëmundjet e veshkave dhe të organeve urinare, te sëmundjet gjinekologjike, te sëmundjet endokrine (të sheqerit), te sëmundjet e sistemit nervor dhe te sëmundjet e lëkurës.

Veprimi shërues i ujit termomineral në Banjat e Dibrës së Madhe-Capa, procedurat e terapisë fizikale, baltës mjekuese dhe kushtet e tjera optimale në këto objekte bashkëkohore, ofrojnë mundësi për kurim, rehabilitim dhe rekreacion të një niveli të lartë cilësor.

Tre milionë euro investime

Mexhit Capa, pronar i Banjave të Dibrës së Madhe, thotë se: "Privatizimi u krye në tetor të vitit 2004, ndërkaq deri në korrik të vitit 2008 kemi investuar 3 milionë euro në rikonstruksion e objekteve hotelierike dhe të pishinave. Në bazë të një plani operativ fillimisht bëmë mbulimin e 1000 metra katrorë të të gjitha pishinave me çati. Në pranverën e vitit 2005 bëmë rikonstruksionin e 38 dhomave me 86 krevatë, të nyjeve sanitare, banjove, inventarit, suvatimin e mureve të Bllokut A në Banjën e Banishtit. Në vitin 2006 bëmë rikonstruksionin e 72 dhomave me 176 krevatë në Hotelin "Termal" në Banjën e Kosovrastit. Në vitin 2007 po në këtë banjë u ndërtua edhe një pishinë. Ndërkaq në Banjën e Banishtit u ndërtuan 2 pishina të reja e 10 vaska dhe u instalua tërë rrjeti elektrik dhe aparaturat elektrikë bashkëkohore. Në vitin 2008 u bë rikonstruksioni i kuzhinës dhe aneksit prej 600 metra katrorë në Banjën e Banishtit, dhe ndërtuam 18 dhoma të reja me 54 shtretër. Në Banjën e Banishtit dhe të Kosovrastit janë ndërtuar fitnet sallat e kompletuara me tërë rekuizitat e kohës.

Ai më tek shton se, "Në hotelin "Uraniku" në qendër të qytetit është ndërtuar dhe pajisur komplet salla e restorantit prej 750 metra katrorë me kapacitet për 500 persona, salla për mbajtjen e konferencave të ndryshme me kapacitet për 250 persona, një kat për zyrat e të punësuarve, vendparkimi prej 200 metra katrorë, taraca e hotelit prej 150 metra katrorë, dhe këndi me lojëra për fëmijë prej 350 metra katrorë. Ndërsa në Banjën e Banishtit në ndërtim e sipër është trim staza dhe stadiumi sportiv, ndërsa në atë të Kosovrastit do të ndërtohen poligone sportive, ku vizitorët dhe ekipet sportive do të mund të qëndrojnë për stërvitje, shprehet pronari Capa.

Shumë të punësuar dhe bursa për profesionistë

Sipas tij, "të gjitha këto investime kanë bërë që, për tre sezone numri i të punësuar nga 134 të arrijë ne 176 persona me tendencë gjithnjë në rritje. Hotelet e këtyre banjave janë të kategorisë super B, me të gjitha kushtet e nevojshme që i takon kësaj kategorie".

Në këtë kuadër të kësaj, shprehet Capa, nuk mungojnë as investimet për specializimin e mjekëve në Universitetin e Shkupit dhe të katër studentëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës, që arrijnë më shumë se 100 mijë euro, duke llogaritur pagat e specialistëve, taksën e shkollimit, bursat e studentëve dhe udhëtimet".

Klientela vendase dhe e huaj

Siç deklaron Capa, "viteve të mëparshme pjesa dërmuese e vizitorëve ishte nga Lugina e Pollogut, pas privatizimit dhe investimeve, tashmë 40 për qind e vizitorëve arrijnë nga Shqipëria, Kosova, Lugina e Preshevës, Suedia, Italia dhe Çekia. Është shtuar edhe numri i vizitorëve të kombësisë maqedonase, i cili arrin 14 për qind i të gjitha kategorive dhe profesioneve".

Bashkëpunim me subjektet vendase

Deri në vitin 1997, ishte njëri nga biznesmenët e fuqishëm. "Kisha bizneset e mia dhe depot me miell dhe mazut në Shqipëri. Dëshira e ime e flaktë për Dibrën e Madhe më kthehu në vendlindje", tregon pronari Capa, i cili më pas shton se me Fondin Shëndetësor ka nënshkruar kontratë prej 210 mijë euro për rehabilitimin e pacientëve.

"Për shërbimet tona maksimalisht i kemi angazhuar subjektet vendase si me shitësit ambulatorë, dyqanet, e taksistët. Furnizimin me artikuj ushqimorë për banjat tona e bëjmë nga tregtarët dibranë, ndërkaq edhe ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve e bëjmë me firma dibrane, me të vetmin qëllim që ta ndihmojmë biznesin dibran", tha në fund pronari i Banjave të Dibrës së Madhe Mexhit Capa.

Rexhep TORTE



Pishinë në Banjat e Dibrës

cyan magenta yellow black

botime

Një libër për Mësuesin e Popullit, Selim Alliu.
Fëmijëria, vitet e rinisë, formimi profesional dhe veprimtaria si mësues.
Një vështrim me dashuri për mësuesin dibran nga Sami Shehu

Selim Alliu, arkitekti i mendimit pedagogjik në Dibër

Nga: **SAMI SHEHU**

Prej kohësh kisha menduar se duhej shkruar diçka për Selim Alliun, për këtë personalitet të arsimit dhe të kulturës në Dibër, për këtë njeri të nderuar e të përkushtuar për të përhapur dritën e diturisë këtyre maleve, për t'i dhënë popullit të Dibrës për një çerek shekulli atë që i kishte munguar prej shekujsh: mësim e dituri për fëmijët, për një brez të tërë djemsh e vajzash që natyra u kishte falur gjithçka.

Për mua dhe shumë të tjerë, Selim Alliu ishte një arkitekt i mendimit e i veprimit pedagogjik, një portret i rrallë i përhapjes së arsimit e kulturës në Dibër dhe mbi gjithçka, një njeri me vlera të shumanshme intelektuale e njerëzore.

Të them të drejtën, kam pritur vite e vite se mos një penë e fuqishme do të merrte guximin për të skicuar veprën e tij, fytyrën e tij, portretin e tij. Më ka shqetësuar dhe një mendim tjetër, një brengë që buronte jo shumë nga nostalgjia për të shkuarën, por një zbrazëtirë që duhej përmbushur, duke qenë i ndërgjegjshëm se nuk do të arrihej ajo që desha e ndoshta, ajo që priste lexuesi i nderuar.


I nxitur nga kjo ndjenjë, kam kapur shpesh penën dhe shpesh faqja ka mbetur në mes.

Më dukej se nuk po shkruaja atë që duhej thënë për të. Të shkruaje për Selim Alliun ishte e vështirë, jo se më mungonin njohja, materiale e bashkëpunëtorët e tij, por se ishte një figurë komplekse në vështrimin e rrethanave ku punoi e jetoi, në një vend delikat e në momente ku çdo njeriu i duhej të orientohej aq mirë e të ecte me aq kujdes, ndryshe bije në humnerë. Dhe, ndoshta merita më e madhe e këtij burri qe se ai me shumë kujdes eci në një truall tepër delikat e të rrëshqitshëm, u orientua mirë, me guxim e mençuri rriti dhe përsosi personalitetin e tij, bëri atë që arsimi dhe kultura në Dibër të ecnin në rrugë të mbarë. Pikërisht në këtë këndvështrim, dalin në pah vlerat reale të këtij misionari. Unë jam i ndërgjegjshëm se me këto që po them, nuk e jap të plotë portretin e tij. Sidoqoftë, le të jetë kjo një nismë e parë, që të tjerë në të ardhmen ta plotësojnë më mirë e ta japin më të plotë veprën e tij në kuadrin e vlerave kombëtare të arsimit tonë që nisi nga e parë e mori ato përmasa që nderojnë të gjithë armatën e madhe të punëtorëve të arsimit dhe të kulturës.

"Selim Alliu ishte një arkitekt i mendimit e i veprimit pedagogjik, një portret i rrallë i përhapjes së arsimit e kulturës në Dibër dhe mbi gjithçka, një njeri me vlera të shumanshme intelektuale e njerëzore."

Jam munduar ta paraqes këtë figurë nëpërmjet jetës së tij, fëmijërisë e rinisë së tij, viteve të formimit të tij profesional e veçanërisht, punës së tij në Dibër si shef i arsimit e i kulturës, si pushtetar me autoritet të padiskutueshëm, si një kuadër me përvojë, si mik e shok, si edukator e projektues i punës mësimore në tërë Dibrën për më shumë se dy dekada.

Selim Alliu është nderuar me titullin më të lartë "Mësues i Popullit", por vlerësimin më të madh ia dha populli i Dibrës, që e ruan në kujtesën e tij veprën dhe ndihmesën që i dha arsimit, një plejadë e tërë nxënësish e mësuesish që u edukuan dhe u frymëzuan nga puna e tij dhe nga jeta e tij. Le të jetë dhe ky libër një kontribut modest për këtë figurë të nderuar të arsimit tonë, botimi i të cilit u realizua nga Shtëpia Botuese "GEER", nën kujdesin e zotit Nexhmedin Dumani



"Risku" sh.p.k.
Market "Ken"

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet



Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup-r.com
e-mail: auroragroup@auroragroup.al

Rruga Arbërit nr. 28

studim

Thesari i fjalëve që konfigurojnë brendinë e termit "audit" janë: inspektim, vështrim hetues, ekzaminim, dëshmim, çekim, rishikim, investigim dhe verifikim. Cilat janë disa prej përmendjeve përkufizuese, që i rrotullohen kuptimësisë së termit "Audit"?

AUDITIMI - SEMANTIKA DHE ETIMOLOGJIA

Nga **QERAM CIBAKU**

Etimologia e termit "audit" buron nga shekulli i 15-të. Fjala "audit" derivon nga latinishtja " audire ", që ka kontekstin anglisht "to hear" dhe kuptimin në shqip "të gjykosh, t'u vesh mëndjen gjërave, të dëgjosh (spjegimet), të shqyrtosh". Praktika e "të gjykuarit të llogarive" buron nga kohët kur pak njerëz mund të lexonin e proklamonin dhe vazhdoi deri në shekullin e 17-të. Kësisoj gradualisht u shëndrruan proceset dëgjimore mbi llogaritë në cikle rigoroze analize rreth të dhënave të shkruara, madje u stimulua tendenca drejtë aplikimit të testeve mbështetëse.

Thesari i fjalëve që konfigurojnë brendinë e termit "audit" janë: inspektim, vështrim hetues, ekzaminim, dëshmim, çekim, rishikim, investigim dhe verifikim.

Po kështu, dhe thesari i përkufizimeve mbi auditimin është i pafund. Kemi zgjedhur e do t'i sjellim në vijim, disa prej përmendjeve përkufizuese, që i rrotullohen kuptimësisë së termit "Audit", simbas fjalorëve, enciklopedive dhe percepsioneve të zbritura nga guida profesionale të kësaj lëmie, pa ndonjë krahasim adekuat.

Auditimi midis fjalorëve

Përgjithësisht, fjalorët enciklopedikë e mistifikojnë auditimin si "pushtet", që merret rëndom me këqyrjet zyrtare të llogarive të një organizate nga teknikë kontabël fort të kualifikuar dhe të çertifikuar. Kësisoj, burimi "Investopedia", (viti 2000, burimi:investopedia. com), anohet të çmojë auditët si "garantë të përpikmërisë fiskale dhe përgjegjshmërisë së organizatës", pa hezituar të shfaqë një ndjenjë "fobie" duke i cilësuar këto profesionistë se "frika kryesore e çdo tatimpaguesi. . . "

Është me interes dhe vlen të merret në konsideratë, formulimi tekniko-gjuhësor, i fokusuar në "Merriam-Webster's Collegiate Dictionary" (botimi i 11-të, 2003), sepse "auditimi është një akt shqyrtimi e gjykimi mbi rezultatin e ekzaminimit të llogarive të një organizate apo të një individi, kurse audituesi është jovetem këqyrësi i librave financiarë të organizatës, por dhe frekuentuesi i kurseve trainuese jashtë punës me qëllim sigurimin e krediteve të pritshme (besimit formal). Nga ana tjetër, vështrimi shkoqitës i "Merriam-Webster's Dictionary of Low" (i vitit 1996), ekspozon këto dy kolona bazë:

a) verifikimi formal i llogarive financiare të individëve ose entiteteve, me qëllim që t'u hiqet mbulesa mashtruese dhe të nxjerrin në dritë pasaktësitë e gabimet në derdhjen e taksave;

b) këqyrje e rregullt metodike dhe rishikim audit i vazhdueshëm".

Pikëtakime e përafri me shtjellimet e mësipërme të funksionit audit, ceken dhe në faqen 49 të "Roget's Super Thesaurus" (përgatitur nga Marc McCutcheon, Ohajo 1998), hasen këto katër kategori rrethformuese e ndëlidhëse:" ekzaminim, llogaritje, rishikim e hetim", krahas misioneve kontabilistë, inspektorë, analistë e rregjistrues.

Jack P. Friedman në botimin e tretë të "Fjalorit të Termave të Biznesit" (Nju York 2000, faqe 42-43) i etiketon auditët "zyrtarë publikë të ngarkuar nga ligjet me funksion për të shkoqitur e verifikuar shpenzimin e fondeve publike" dhe si "kontabilistë që performojnë funksione homogjene e të ngjashme për palë të treta".

"Një kërkesë ligjore për kompanitë aksionere janë bilancet e llogaritë e fitim-humbjeve dhe sistemi themelor i llogarive e shënimeve të ekzaminuara nga auditët e kualifikuar, -përcakton C. Pass në "Dictionary of Economics" (botimi i tretë)-që të mundësojnë kësisoj një opinion përsa u përket këtyre çështjeve". Megjithëse në Fjalorin Terminologjik Bankar ekzaminimi i librave të llogarive zbërthehet si më sipër, aty cilesisht nënvizohet detyrimi që "një letër opinioni e përgatitur nga auditët i bashkangjitet raportit vjetor". (Shiko:Thomas P. Fitch, "Dictionary of Banking Terms", botimi i 4-rt, Nju York 2000, faqe 30-31).

Veçanësia midis perceptimit të këtij profesioni nga "Dictionary of Small Business" dhe "Oxford Talking Dictionary", qëndron në këndvështrimet e tyre origjinale. Kështu, tek i pari auditimi çmohet si një ekzaminim zhbirilues dhe verifikim profesional skrutinor (zakonisht nga ekspertë të pavarur, kontabilistë publikë të çertifikuar);si një rishikim nga llogaritarë të ndershëm të dokumentave dhe letrave te punes së llogarisë me synim pasqyrimin e punëve dhe dhënien e një opinioni të drejtë, të paanshëm e të pandikuar. Për ndryshe, "Oxford talking dictionary" e mvesh misionin e auditimit me atributin e "hetimit të informacionit, të rishikimit të imtësishëm metodik dhe të shqyrtimit ligjor të ekzaminimeve". Gjithashtu parashihen hollësi mbi përgjegjësitë e vleresimeve dhe vistimeve të rregullta metodike të posteve të bilancit;ujdisje të hesapeve të llogarive të pronarit, bujtinarit, qeradhënësit nga njera anë dhe kundërpalës respektive, nga ana tjetër.

Një shtrirje tipike e konfigurim të funksioneve auditive, gjejmë në trashëgiminë e librit "Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English" (botimi i 5-të, nga A. S. Hornby, viti 1998, faqe 67). Thelbi i përkufizimit që fikson ky fjalor, koncentrohet te:"Një verifikim zyrtar i llogarive të një kompanie për të parë nëse ato janë të vërteta e korrekte;një ekzaminim i cilësisë, ekzistencës fizike dhe efiçensës". Komenti vijohet me shprehjet "raport vjetor auditimi" dhe "përgatitja e llogarive për auditim". Ky vëllim e lidh ngushtë profesionin e auditimit me testime formale të njohurive dhe me aksione inspektimi të befasishëm në qëllim të formulimit të opinioneve të vërteta e të pandikuara.

Sakaq, tjetër qasje leksikore harmonike, ofrohet prej kompanisë "Haughton Mifflin", nga veçuam pasazhin:"Auditimi është 1-këqyrje vjetore, e pavarur e të dhënave dhe llogarive financiare, me qëllim që të gjykohet rreth përpikmërisë së tyre;2-ndreqje, axhustin e korrektim i llogarive; 3-ekzaminim e verifikim i llogarive"-(këputur nga "The American Heritage:Dictionary of English Language", botimi i 4-rt, viti 2004).

Kategoria e fjalorëve Collin's kurojnë një vështrim më të imtësishëm mbi semantikën e termit që po analizojmë. Cilesuar si "banka angleze e fjalëve" dhe si një databejs unik leksikor me 524 milionë fjalë, "Collins English Dictionary" (botimi i 6-të, nga Harper Collin, Britani e Madhe, viti 2004, faqe 105), zbërthen auditimin si "inspektim, çekim, korrigjim, verifikim e çertifikim të llogarive të biznesit prej kontabilistësh të kualifikuar mirë e të pavarur". Aty nënvizohet gjithashtu përveç versionit arkaik të kësaj shprehje dhe funksioni i Auditit të Përgjithshëm të Kanadasë, njohur si"zyrtar i lartë federal, përgjegjës për auditimin e departamenteve qeveritare dhe bërjen e raporteve vjetore".

Auditimi shikohet si "një këqyrje prej një pale jashtë organizatës të llogarive të një individi ose të një kompanie" në librin "The new dictionary of cultural literacy" (botimi i 3-të nga J. Hirsch, F. Kett dhe T. James, viti 2002).

Auditimi në rrezatimin enciklopedik

"Auditimi është ekzaminimi i aktiviteteve, të dhënave dhe raporteve të ndërmarrjeve prej specialistëve të llogarisë, që nuk janë të njëjtët llogaritarë-përgjegjës për përgatitjen e tyre. Auditimi publik nga llogaritarë të pavarur ka siguruar një status profesional dhe po bëhet gjithnjë e më shumë unik me rritjen e madhësisë së bisneseve dhe me ndarjen e pronarëve nga kontrolli. Auditët publikë performojnë teste, përmes së cilave ato përcaktojnë pozitën e ndershmërisë aktuale të operacioneve financiare të firmave dhe rezultatet e operacioneve. Këto vlerësime të pavarura mbi raportet e drejtimit bëjnë pjesë në interesat aktuale dhe perspektive të aksionerëve, bankierëve, shitësve, klientëve dhe agjensive qeveritare.

Në vendet anglishtfolëse auditët publikë zakonisht janë të çertifikuar dhe inkurajohen të zbatojnë standarte të larta të organizmave profesionalë. Shumë vende Europiane dhe komonuelthi i kombeve Britanike, ndjekin shembullin e Britanisë së Madhe ku organizatat e çertifikuara të kontabilistëve, kanë zhvilluar standartet në gjurmët e tyre. Të tjera vende vijojnë sipas praktikave të SH. B. A-ve, ku parashtrohen kërkesa legale për liçensim. Shumë vende kanë ngritur agjensi e departamente specifike me auditë për vlerësimin e llogarive, (p. sh Zyra e GAO-s në Amerike apo Cour des Comptes në Francë). Auditimi i brendshëm është relativisht i ri dhe ai projektohet si një kërkesë e manaxhimentit, për të vërtetuar rregullaritetin dhe për të fiksuar sistemin kolektiv adekuat që manaxhimi të zbatojë në vijimësi. Ndoshta tipi më i familjarizuar i auditimit është auditimi administrativ ose pre-auditi (lexo:auditi paraprak), që nis me faturat, dëftesat, kuponat dhe dokumenta të tjera që investigohen për saktësinë dhe autorizimin, përpara se ato të kalojnë për pagesë e rregjistrim në librat financiarë"-shkruhet në "The New Encyclopædia Britannica" (botimi i 15-të, 1983, volumi i parë, faqe 643).

Gjithashtu, në vështrimin e "The World Book Encyclopedia" (botim i vitit 1994, emetuar nga kompania Scott Fetzer, volumi i parë, faqe 884) auditimi plazmohet si "shqyrtim dhe ekzaminim zyrtar e sistematik të aktiviteteve të biznesit. Këto aktivitete mund të jenë të organizatave publike ose private. Organizime të tilla u besohen auditëve, për të dhënë këshilla të pavarura dhe ekspertizë për bizneset. Një person që përcjell një auditim quhet auditues. Ekzistojnë tre lloje auditimesh:financiar, të pajtueshmërisë dhe operacional. Një auditim financiar çekon sigurinë e informacionit financiar. Auditimi i pajtueshmërisë përcakton nëse një organizatë ka ndjekur politikat e brendëshme në përputhje me ligjet, rregullat dhe kontratat. Auditimi operacional është i prirur të ndihmojë organizatën për t'u bërë më produktive dhe më fitimprurëse. Fjala audit rrjedh nga një fjalë latine. Auditimi filloi që në kohët antike, por teknikat moderne të auditimit kanë si origjinë Anglinë e mesviteve 1800. Në ditët e sotme, qëllimi magjistral i auditimit është zbulimi i mashtrimeve"-kumton Richard P. Brief.

"Encarta/Encyclopedia 2000" (emetuar nga Microsoft Corp.) filtron tre parakushte që vendosin të marrurit dhe rekrutimin obligator nën këtë profesion:niveli i lartë i specializimit mbi auditimin, taksimin dhe organizatat jashtë bisnesit. Në vijim:"Auditimi është ekzaminimi nga llogaritarë të pavarur i informacioneve financiare, i të dhënave të llogarive, i dokumentave të biznesit dhe i dokumentacionit tjetër që lidhet më çështjet e një organizate, me qëllim që të dëshmohet përpikmëria në formulimet dhe paraqitjet financiare. Bizneset dhe gjithë nivelet e qeverisjes në SHBA angazhojnë llogaritarë publikë të çertifikuar (CPA) për të bërë ekzaminimet e auditimit. Auditët inspektojnë dhe verifikojnë saktësinë e të dhënave dhe paraqitjeve financiare. Administrimi i auditëve bëhet me qëllim që ato të nxjerrin në shesh gabimet e librave të llogarive dhe gjithashtu të japin viston për ndershmërinë e të punësuarve".

Në rrafshin psikologjik "Collins Discovery Encyclopedia", (Edicioni i I-rë, Gllasgou 2005, faqe 41), ngre një mizanskenë diskrete lidhjesh midis fjalës auditim dhe fiziologjisë si "shfaqje e fuqisë së të kuptuarit dhe si percepsion që vjen nga ndëgjimi i vëmendshëm", (konotacion i gjendjes së gatishmërisë për thithjen e interceptimit dhe zhbërjen e mistifikueses nga një proces kudesi e tendosje). . .

Imazhi dhe zbërthimi që shpalos "The Columbia Encyclopedia" (përgatitur nga Paul Legassé, botimi i 6-të, viti 2003) rreth auditimit, sillet përkrah sentencës se "auditimi është ekzaminimi dhe ekspozimi i gjendjeve të llogarive dhe dokumentacionit të afërt e të lidhur me to, nga persona që nuk janë pjesë e përgatitjes së këtyre dokumentave". Trajtimet enciklopedike sqarojnë se sistemi i inspektimeve financiare është përdorur shumë e shumë kohë më parë, sidomos për llogaritë publike. Në Itali epoka e elaboracionizmit tregtar, konsiderohet si periudha e konstituimit të funksioneve auditive. Por, auditimi i subjekteve publike nuk u bë i mundur deri në shekullin e 19-të, kohë kur bisneset u rritën në vijimësi si në numër dhe në madhësinë e tyre. Kartat e Themelimit të Korporatave shoqëroheshin me kushtin që ekspertë të licensuar duhet të drejtojnë e kryejnë auditimet vjetore. Në këtë mënyrë, auditët u quajtën vlerë e dobi e posaçme për pronarët (partnerët dhe zotëruesit e aksioneve); për ekzekutivin (manaxherët, zyrtarët dhe drejtorët); për kreditorët dhe krediteusit perspektiv të mundshëm (investitorët, komisionerët, bankierët tregtarë dhe ato të investimeve), për administratën e pasurisë, për trustet, komitetin e kreditorëve të bisnesit etj. Auditët sipas Enciklopedisë, janë çmuar si dobi dhe për shitësit e firmave komerciale, pronarët e patentave dhe pjesmarrësit në pjesët e fitimeve apo royalti-së, për trupat qeveritare dhe donatorët perspektivë të institucioneve publike. Për rrjedhojë auditimi konsiderohet si një këqyrje dhe vlerësim i pavarur, që ka tendencë të shtojë asetet dhe të pakësojë detyrimet.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Një letërkëmbim interesant të atdhetarit dhe publicistit dibran Josif Bageri me atdhetarin vlonjat Ibrahim Shyti. Puna dhe veprimtaria e tyre për cështjen kombëtare.

Dukuri të letrave të Ibrahim Shytit me patriotin dibran Josif Bageri

Nga: Dr. **BERNARD ZOTAJ**

Josif Bageri ishte një ndër figurat më të shquara të Rilindjes sonë kombëtare i lindur në Rekë të Epërme të Gostivarit. Ishte poet me talent, prozator, gazetar, publicist, si dhe atdhetar i flakët, i cili jetën e tij ja kushtoi çështjes kombëtare shqiptare.

Josif Bageri lindi në vitin 1870 në fshatin Nistorvë, që në atë kohë administrativisht i takonte sanxhakut të Dibrës dhe sot Gostivarit. Fëmijërinë dhe një pjesë të rinisë i kaloi në vendlindje. Për shkak të rrethanave politike të kohës Josif nuk pati mundësi të filloj shkollimin në moshën e duhur. Leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe e përvetësoi në Sofje kur ishte 17 vjeç. Aty jetoi si mërgimtarë.

Josifi në Sofje që nga vitit 1887 u inkuadrua në lëvizjen kombëtare shqiptare. Në këtë kohë në Sofja ishte e mbushur me atdhetarë, te cilët i ndiqte pushteti osman se merreshin me veprimtari patriotike.

Dukuri atdhetare të Josif Bagerit

Gjat periudhës së viteve 1905-1907 Josifi ndihmoj shumë në përhapjen e arsimit shqip ndër masat popullore. Ishte luftëtar i denjë për gjuhën dhe shkollën shqipe dhe si rezultat i sajë, në shtator të vitit 1908 në fshatin e tij të lindjes hapi edhe një shkollë shqipe.

Në maj të vitit 1910, në Sofje fillon të botojë gazetën me titull "Shqypeja e Shqypnisë", e cila luajti një rol të madh në përhapjen e arsimit dhe në trajtimin e çështjes kombëtare.

Atdhetari dhe publicisti Josif Gageri që drejtonte gazetën "Shqypeja e Shqypnisë", ka pasur një letër këmbim të vazhdueshëm me Ibrahim Shyti prej Vlore. Ai e përgëzonte për punën atdhetare që bënte në Vlorë dhe i dërgoi dhe librin e tij "Kopështi Malësori", më 27 mars 1910.

Kështillat e Josif Bageri patën ndikim të madhe te Ibrahim Shyti, ku shpesh xhonturqit i ndalonin të shiste gazeta shqipe të kolonive shqiptare të mërgimit. Josif Bageri në letrën e ti i shkruan se: "ju na shkruani se gazetën tonë e kanë ndaluar në Vlorë...", duke e këshilluar që ta shpërndajë dhe propagandojë ku hapur dhe ku fshehtas.

Në një letër tjetër më 3 korrik 1910 e përgëzon "për përpjekjen tuaj... për të mirën e kombit, tuj përhap fletën tonë kombëtare...", por dhe e këshillon dhe udhëzon që mëmëdhetarët e Vlorës të organizojnë Komitetin për Lirinë e Shqipërisë dhe për organizimin e luftës së armatosur kundër xhonturqve.

Kushtrim për atdhetarët vlonjatë

Ibrahim Shyti duke u nxitur prej tyre bisedoi me mjaft atdhetarë të njohur të kohës për organizimin e vlonjatëve në një shoqëri atdhetare.

Fjalët e dërguar prej Josif Bagerit, në letër ai bëri kushtrim te atdhetarët vlonjate, të cilat u bënë nxitje për një veprimtari më të madhe. Ato u bënë kushtrim për atdhetarizëm dhe jehuan gjatë në mendjet dhe zemrat e tyre duke jehuar në çdo kohë "...të lutem o vëlla i dashur... t'i mbledhësh gjithë ata shqiptarët e flaktë muhamedanë e të krishterë e në një dhomë (odë) dhe zihi vëllazërisht dorë për dore dhe të betohi vëllazërisht në emër të Perëndisë dhe të Shqipërisë dhe puthni kuranin dhe ungjillin, kështu pra, edhe gjashtoren edhe shpatën. Dhe mbasandaj të rrokni vllazërisht e të përqafoni dhe të puthni gojë më gojë dhe të thoni: "O besa-besë, do të vdesim për Shqipërinë, si trima shqypëtarë dhe kurrë s'tradhëtojmë njëri-tjetrin..."

Dhe siç shkruan në kujtimet e tij, Beqir Velo-Kanina u mblodhëm dhe kuvenduam me njeri-tjetrin "për formimin e një shoqërie", ku më vonë u krijua Komiteti "Shoqëri e zezë për shpëtim".

"...unë mblodha në Vlorë dhe nga goja e Ibrahim Shytit kujtime të tij për Josif Bagerin dhe gërmova në arkivin familjar të tij shkresa të ndryshme...".

Ibrahim Shyti



Në letrat e Josifit që i drejtohet Ibrahim Shytit shkruhen me këto fjalë: "I dashur vëlla gjaku dhe gjuhe, Ibrahim Shyti! Letrat e zotnisë tuaj i mora të tria dhe portretin e bukur, të cilin e putha prej malli, aq shumë prej gazmendi, se ju, një djalë i vogël, boni punë të madhe për shndritjen e kombit, të cilin shërbim askush s'e bon si e boni ju... e në fund shkruan, ju përqafoj me mall të madh unë, rob i kombit shqiptar: Josif Bagëri".

Fort shum i dashuri atëdhëtar zotëni Ibrahim Vlora gjat-jeto për të mirën e Shqypënisë! " ...shpresojmë, se do t'a mbushni detyrën si shqypëtar i vërtet dhe dot'na shkrueni një për një, që të dim se ç'ka boni atje... ...shkruani pak m'a çkoqitur që të mundim t'a leçitim ma me lehtësi". `

"... jam shum gzuet, se përpiqi fort shum për Shqipërin...".

"Tani të lutem, o vëlla i dashur Ibrahim, t'i mbledhish gjith ata shqiptarët e flakët e muhamedanë e të krishterë e në një dhomë (odë) dhe të zihi vëllazërisht dorë për dore dhe të betohi vëllazërisht në emër të perëndisë dhe të Shqipërisë dhe të puthni kuranin dhe ungjillin, kështu pra dhe gjashtoren dhe shpatën dhe pastaj të roki vëllazërisht dhe të përqafoi dhe të puthi goja në gojë dhe të thoni: o besa besë do të vdisni për Shqypërinë si trima shqyptarë dhe kurr s'tradhëtojmë njani-tjetrin! ... O burrani t'ju shoh trimërinë e




juaj".

"... vëlla gjaku dhe gjuhe Ibrahim Shyti, letrat e zotënisë juej i mora të tria dhe portretin e bukur të cilën e putha prej malli, aq ma shum prej gazmendi, se ju një djalë i vogël, boni pun të madhe për shëndritjen e kombit, të cilën shërbim kurrkush s'e bon ashtu si e boni ju".

"U lutem shumë e shumë, or vëlla i dashur, të na shkruash me rregull të reja dhe të na rrfejsh se sa prija (çeta) kan dalë për lirinë e kombit nëpër malet. Shkruani nëse u goditën m'donjë vend me ushtrinë dhe sa ushtarë e prijas janë të vrarë".

Ëndrra patriotike për Shqipëri të lirë dhe të pavarur

Duke hyrë në marrëdhënie me J. Bagerin, I. Shyti nisi të shkruajë artikuj në gazetën "Shqypeja e Shqypnisë". Në faqet e kësaj gazete, copëzat e botuara dhe të përm-



bledhura në librin "Kopështi i Malësorit" shprehin qartë motivet e ndryshme patriotike të autorit, motivet e ëndrrës së tij për një Shqipëri të lirë e të përparuar. Ashtu si shkrimtarët e tjerë të Rilindjes Kombëtare, në radhët e këtyre letrave, në vjershërimet e shkrimet e gazetës së tij, shpreh nevojën e kultivimit të kombit shqiptar, sidomos përhapjes së shkrimit të gjuhës shqipe. Nëpërmjet këshillave të tij I. Shyti kuptoi



Josif Bageri

dhe më mirë, në ato kohë të trazuar të jetës shqiptare, detyrën e shenjtë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.

Në letrën e 28 gushtit 1910, ai e këshillon I. Shytin, që të mësojë mirë alfabetin kombëtar që: "fjalët dhe shkronjat të jenë të shkoqura...". Në faqet e librit "Kopështi i Malësorit" janë pasqyruar edhe disa fjalë e thënie të urta. "Fjalë të mënçura të Josif Bagërit", u botuan prej Abraham Shytit në një broshurë dhe në vitete 1919-1920, u shërbyen mësuesëve të shkollave të Vlorës për edukimin atdhetar të nxënësve.

Me shpalljen e Pavarësisë kombëtare më 28 Nëntor 1912, Josi Bageri i shkruan mikut të tij I. Shyti, me gëzim të madh se dëshironte të largohej nga Sofja dhe të vinte në Shqipërinë e lirë e të pavarur. Me nota dëshpërimi nga gjendja e rëndë ekonomike, ai i lutet mikut të tij: " ...unë shumë dua të vi atje, por fati i shkretë s'më hecën..."

Takim me miqtë e zemrës

Josif Bagëri erdhi në Shqipëri, ku qëndroi në Durrës, zuri punë në një shtypshkronjë të qytetit. Ngjarjet rodhën të rënda; shtypshkronja u mbyll, sëmundja dhe kushtet ekonomike bënë që të mos shkojë në Vlorë.

I. Shyti shkoi vet në Durrës dhe takoi mikun e zemrës dhe bisedoi gjatë me të. Në korrik 1914 I. Shyti ishte në Durrës me I. Qemalin, ku takoi Princ Vidin. Ibrahim Shyti u lumturua kur I. Qemali kuvendoi me Josif Bagërin duke e falënderuar atë: "për atdhetarinë e nxehtë në shërbim të kombit".


Josif Bagëri vdiq në Prishtinë në vitin 1915, kjo shkaktoi një dhimbje të madhe për I. Shytin dhe atdhetarët e tjerë në Vlorë.

Nga dashuria e madhe për shkrimtarin Josif Bageri, në fillim të viteve '50, Ibrahim Shyti u drejtoi një letër gazetave e revistave shqiptare: "të shkruhen pak radhë për këtë atdhetar të përvëluar". Në ato vite Ibrahimi u

MIQTË PËR JOSIFIN

Më 15 korrik 1937 Haki Stërmilli u interesua për mbledhjen e materialeve të letërkombimeve të Josif Bagërit, prandaj i lutej I. Shytit: "Do t'ju jem mirënjohës dhe këtë mirënjohje do ta shfaqim në librin që do të botojmë, në asht se Zotnia Juaj do të kini mirësinë me na i dërgue ato letra ose kupjet e tyre..."
Nga epistolari i I. Shytit mësojmë se krahas letrave ai i pati dërguar shkrimtarit H. Stërmilli edhe disa shënime mbi jetën dhe veprimtarinë publicistike e atdhetare të J. Bagërit

takua dhe bisedoi me kritikun letrar Drago Siliqi, studiuesin Vehbi Bala, shkrimtarin Petro Marko dhe historianin Petraq Pepo. Ibrahimi i dha



për botim Pepos katër letra origjinale të Josifit si dhe të dhëna për jetën e tij, të cilat u botuan në shtypin e kohës me titull "Katër letra të shkrimtarit democrat Josif Bageri".

Josofi Bageri punoi shumë për cështjen shqiptare. Punoi pa u lodhur, duke lënë pas shumë shkrime të botuara e të pabotuara; poezi e prozë, platforma politike, artikuj, komente, reagime, lidhje politike etj. Gjatë veprimtarisë së tij pati një bashkëpunim te ngushtë dhe shumë atdhetar të tjerë.

Personaliteti dhe veprat e tij politike, letrare e publicistike meritojnë respekt të lartë nga të gjithë vlonjatët e çdo kohe.

-Letra e Josif Bagerit, 28 gusht 1910, drejtuar Ibrahim Shytit.
-Letër e Josif Bagërit nga Sofja dërguar I. Shytit në Vlorë, më 27 të Marsit 1910 m.
-Letër e Josif Bagërit dërguar nga Sofja I. Shytit në Vlorë, më 6 qershor 1910.
-Letër e Josif Bagërit dërguar nga Sofja I. Shytit në Vlorë, më 3 të korrikut 1910.
-Letër e Josif Bagërit dërguar nga Sofja I. Shytit në Vlorë, më 28 të Gushtit 1910 m.

Maj 2007

Kontaktet e patriotëve të Zogjes me ato të Dibrës e Kosovës pas hapjes së shkollave shqipe në Korçë dhe Dibër të Madhe i dhanë impulse të reja punës për mësimin e gjuhës shqipe në Grykën e Vogël.

Arsimi dhe kultura në fshatin Zogje

Nga **ZABIT LLESHI**

Kontaktet e patriotëve të Zogjes me ato të Dibrës e Kosovës pas hapjes së shkollave shqipe në Korçë dhe Dibër të Madhe i dhanë impulse të reja punës për mësimin e gjuhës shqipe në Grykën e Vogël. Kuvendi i Dibrës i vitit 1899 miratoi një varg kërkesash që çuan në zhvillimin kulturor të kombit, në ruajtjen dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, në themelimin e shkollave shqipe, në sigurimin e mjeteve të nevojshme për hapjen e këtyre shkollave (Kristaq Prifti e Dibra dhe etnokultura e saj, V 1, f. 205. Përfaqësuesit e Grykës së Vogël në Kongresin e Dibrës ishin Bajram Markja dhe Tush Lleshi nga Zogjet dhe Jashar e Shaban Dema nga Homeshi. Këto patriot iu përveshën punës për zbatimin e rezolutës prej 12 pikash siç ishin: Bashkimi i popullsisë së Sanxhakut të Dibrës në Lidhjen e Pejës, ndaloheshin armiqësitë, grindjet, organizimin e forcave ushtarake vullnetare që do të përdoreshin për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë nga çdo sulm i mundëshëm sllavo-rus. Në mënyrë të veçantë u rrit puna për mësimin e gjuhës shqipe. Bashkëpunimi me Seid Najdenin në vitet e para të shekullit 20 dha frutet e para. Librat shqip që morën në Manastir dhe Dibër të Madhe Bajram Markja dhe Tush Lleshi i sollën në Grykën e Vogël ilegalisht. Teqja e Bllacës u bë shkolla e parë dhe baza për mësim shqip. Nën ndikimin e Selim Rusit, Seid Najdenit në vitet e tronditjeve të mëdha nga lëvizjet patriotike të Pejës, Dibrës, Gjakovës, Prizrenit, Shkupit kundër Perandorisë osmane për autonomi dhe hapjen e shkollave shqipe(1899-1900) Jashar Zeneli u bashkua me këtë lëvizje në moshë të re, mesoi gjuhën shqipe dhe u bë ndër mësuesit e parë të gjuhës shqipe në Grykën e Vogël. Nga mënyra se si mësohej shkolla në Teqe ajo u quajt tinzare e fshehtë, ilegale.

Nxënësit e parë ishin Seit Tasha, Aqif Lleshi, Osman Xheka në vitet 1903-1904. Këto patriot të Grykës së Vogël si Selim Rusi, Tush Lleshi, Bajram Markja, Shaqir Daci, Shaban Dema, Mersim Dema, Jashar Zeneli, përgaditën mësues të tjerë duke u bërë propogandues të zellshëm të çështjes kombëtare që do të çonte drejt pavarsisë së Shqipërisë por që Dibrës i takoi të ngrihej në luftë për mbrojtjen e saj. Janë të njohur në histori përballja me serbët në fundin e vitit 1912 dhe fillimet e 1913, lufta heroike e Mersim Demës, Halit Lleshit, Pëllumb Lleshit, Sheh Sula i Zerqanit, Dan Cami, Aqif Lleshi etj. (M. Murra Lufta e Grykës së Vogël 1912-1913 dhe Dibra dhe etnokultura e saj v 1 faqe 277-289. Meqenëse objekti i këtij shkrimi janë problemet e arsimit mund të themi se kryengritjet e viteve 1910-1912, lufta e parë botërore dhe ato kundër invazioneve bullgare, austriake e serbe deri në vitin 1920, do të ngadalësonin e pengonin vrullin për hapjen e shkollave shqipe në Dibër e në mënyrë të veçantë në Grykën e Vogël. Në vitet 1920-1930 rinis puna për hapjen e shkollave shqipe në Grykën e Vogël. Në xhami mësohej arabisht e turqisht nga Rustem Lleshi dhe më vonë Sinan Lleshi i cili kishte mbaruar medresenë në Manastir. Në vitin 1929 u hap shkolla në Zogje. Gjatë ndërprerjes së shkollës mjaft nxënës si Demir Leka, Qamil Lleshi shkonin në shkollën e Homeshit. Mjaft të tjerë mësuan si audidakt siç ishin Man Leka, Ali Leka, Pëllumb Lleshi, Iljaz Suti etj



Në vitin 1932-1933 u ndërtua shkolla e re afër xhamisë me kontribut të Aqif Lleshit. Shkollën e ndërtoi mjeshtri Nexhmedin Murgu nga Lubaleshi i cili megjithë presionet që iu bënë nga pjesa konservatore e parisë së Dibrës (atë e plagosën) shkollën e ndërtoi. Kjo ishte një ngjarje me rëndësi për fshatin. Për ndërtimin e kësaj shkolle u kujdesën dhe kryepleqtë e fshatrave Stushaj, Zogje dhe Bllacë. Mësuesit që kanë punuar në Zogje janë Faik Begu me të shoqen e tij, Jonuz Shehu, Sabri Apulja, Ramiz Alliu, Aqif Pasholli, Kadri Kashari, Shaqir Shaba, Osman Leka, Bardhul Zeneli, Elez Xheka, Fehmi Xhiveshi, Ibrahim Dervishi, Selim Kamberi, Hamdi Dumani, Violeta Dema, Ali Kaja, Dylbere Toci, Muharrem Alimani, Haxhi Leka, . Mësuesja e parë femër në Grykë të Vogël ka qenë Rreme Tasha e cila ka punuar në Bllacë në vitet 1954-1955.

Kanë mbaruar shkollën për oficerë Man Leka, Iljaz Markja, Shaban Leka, Imer Lleshi, Ramiz e Kalosh Daci, , Shahin Leka. Shkollën pedagogjike Osman Leka, Ali Kaja, Violeta Dema, Haxhi Leka, Drita Lila, Zabit Lleshi, Trëndafile Lleshi, Fllanza Lleshi, Shqipe Leka. Shkollën "Hari Fulltz" Demir Leka. Në vitin 1959 u hap shkolla 7 vjeçare viti i parë në Kovashicë. Në vitin 1960-1961 u ndërtua shkolla e re Zogje(Mazhicë, Stushaj, Bllacë, Zogje). Mësues dhe drejtor i parë Abaz Xhafa (normalist, futbollist i ekipit të Elbasanit). Në shkollën shtatë vjeçare kanë punuar si mësues Ali Puca Zerqan, Hyqmet Tasha, Hamdi Pira Kishavec, Ahmet Tomja, Zabit Shehu, Skënder Kuta, Ramiz Leka, Hamdi Dani, Mentor Nasufi, Hamza Manjani, Dyrmish Shehu, Hyqmet Tasha, Mendu Dema, Zabit Lleshi, Avni Toci, Farie Spahiu, Nexhmije Dumani, Medi Dema, Latif Manjani, Servete Tomja, Drita Sinani, File Tasha, Skënder Zeneli, Rabie Alimani, Xhevat Jella, Shukri Xheleka, Ivzi Muça, Bardhyl Manjani, Zabit Kaci, Fisnik Manjani. Në shkollën e re 7 vjeçare në Zogje në vitin 1963 mbaruan për herë të parë klasën e shtatë 17 nxënës. Vajzat e para ishin Vjollca Xhafa, Lume Xhafa, Drita Lila, Myzejen Dumani. Shkolla 7 vjeçare Zogje në saj të punës së mësuesve dhe falë kujdesit arsimdashës të popullit u bë ndër shkollat më të mira të rrethit të Dibrës. Këtë emër të mirë ajo e ruajti edhe në saj të punës së mirë drejtuese të Ramiz Lekës, Hyqmet Tashës, Avni Toçit Bardhyl Manjanit, Gëzim Dumanit Mahmut Koxhës, Ardian Kajës e Agim Xhafës.

Nga shkolla e Zogje kanë mbaruar shkollat e mesme dhe të larta dhe punojnë në shumë qytete e rrethe të vendit tonë. Mjaft kudro që mbaruan pas vitit 1963 si oficerë Nazmi Seiti, Sabedin Toçi, Myzejen Dumani, Xhevdet Tasha, Latif Dumani. Mësues Zabit Lleshi, Kamber Xhafa, Avni Toçi, Drita Lila, Nexhmije Dumani, Ferit Dumani, Dylbere Toçi, Fllanza Lleshi, Rabie Alimani.

Mjek Gani Kola, Nazmi Kaja, Vjollca Lleshi, Resmie Xhafa, Servete Daci, Lule Lleshi. Teknik të mesëm si Bashkim Dumani, Naim Xhafa, Shehat Krusa, Medi Gjeci, Qazim Xhafa, Njazi Lleshi, Rasim Daci, Lirim Lleshi etj. Ekonomist Xhevrie Balliu, Latif Leka, Nafie Xhafa, Ahmet Jakini. Në vitin 1969 hapet shkolla 8 vjeçare në Gjuras dhe në vitin 1970 në Topojan. Në vitin 1970 shkollë fillore kishte në çdo fshat. Në shëndetsi kanë punuar si infermier Musa Manjani, Haxhi Xheka, Lume Kuka, Refide Toçi, Hysni Lepuri, Behije Llani, Asime Daci, Mimoza Dumani ndërsa mjek Sokol Agalliu, Shahin Kaja, dentist Miftar Veshi,. Ndërsa në shërbimet tregtare janë dalluar Lahim Leka, Zemrie Daci, e Lume Kaja. Nga Zogjet kanë dalë ose kanë origjinën Shahin Leka prof në fushën e artit ushtarak, Luljeta Lleshi prof në fushën e mjeksisë, Bashkim Lleshi prof. në fushën e gjeologjisë, Nazmi Kaja doktor i shkencave në mjeksi, Rushit Lleshi diplomaci, Nazmi Suti inxhinier në aviacion, Gëzim Lleshi avokat. Kanë mbaruar studimet për inxhinieri mjedisi Desareta Lleshi, Dilaver Lleshi.

Zogje mund të quhet dhe fshat i deputetëve. Afër një shekull ka patur deputet përfaqësues të popullit në kuvendin e republikës. Në vitin 1920 Ramiz Daci ishte deputet i Drinit, pastaj Aqif Lleshi deputet i shqiptarëve të Maqedonisë, Haxhi Lleshi, Kep Lleshi, Bukurie Lleshi(Kaja), Ismail Lleshi dhe së fundi dhe Ardit Kaja. Kultura e fshatit Zogje pasqyrohet bukur dhe në ndërtimin e shtëpive ku ndoshta janë karakteristike në zonën. Shtëpitë janë të ndërtuara prej muri guri dhe çatitë janë të mbuluara me rrasa po prej guri.

Dhomat janë me dritare të mëdha për ndriçim dhe ajrosje dhe dyshemeja e punuar në mënyrë artistike prej dërrase të punuar mirë. Karakteristikë në fshat janë ballkonet e dala para fasadës(disa i quajnë çardak, telis) të punuara edhe këto me dru . Mjeshtrat e punimit të drurit si dhe gdhendjes së gurit ia vlen të përmendim Adem Lleshi, Qamil Kaja, Ismail Kaja, Beqir Markja, Xhelal Lleshi, Vehbi Lleshi, Adem Kaja, Lazim Leka, Subi Markja, Kujtim Toçi. Uniteti i vetë fshatit ka ndikuar që jo vetëm të kulturuar brenda për brenda banesës por dhe jashtë saj në rrugë dhe mjedise publike fshati Zogje është shquar vazhdimisht. Janë vetë fshatarët që kujdesen në mënyrë të veçantë edhe për pastërtinë e rrugëve, karakteristikë kjo dalluese edhe për fshatrat e tjerë.

Rakip Alliu, mësuesi i përkushtuar

Nga: **YMER KETA**

Tek Bulqiza dhe bulqizakët, tek çdo cep i Arbërisë gjen dritën e fisnikërisë.

Treva e Dibrës, krahina e Bulqizës, çdo vep a fis i saj, sikudo në atdheun tonë, ka një histori, ka gjurmë diturie e besë, ka gdhendur kararet, si dhe shpirtin atdhetar të brezave. Bulqiza e qëndresës dhe e besës, lindi fisnik e prijës popullor si Fejzë Çanga, trimat që dhanë prova si Selman Lika, Zenel Çemeta, Ali Shkina, Dalip Karaj, Malë Dani, Mehmet Duriçi, Destan Cara dhe Ahmet Xhaferri. Në mjedise urtësia e traditash të vyera të fiseve të fshatit Dushaj, fshat i njohur ky në krahina lindi dhe u rrit dhe Rakip Alliu, në vitin 1936 në një familje të varfër. Fëmijëria e tij ishte disi e mirë, e filloi shkollën fillore në fshatin e tij të lindjes dhe uniken e pedagogjiken i mbaroi në qytetin e Tiranës, ku atje u njoh me shokë të tij si Dilaver Rama e Hasan Duriçi, ku pas mbarimit të pedagogjikes, u caktuan mësues në ciklin e ulët në fshatin Dushaj e Fushë. Në vitin 1955, në fshatin e tij e filloi punën me mjaft dëshirë edhe pse kishte bërë shkollë të rregullt, Rakipi u mbështet tek eksperienca e mësuesve të vjetër si Xhafer Jangulli si dhe nuk harroi porositë e çmuara të profesorëve të tij si Shefik Osmani e Petro Marko. Gjithashtu kujtonte me respekt të madh mësuesin Osman Shehu. Kavajasi që e kishte mësuar të shkruajë e të lexojë, e që u jepte porosi nxënësve, duke ju thënë se, ju jeni e ardhmja e këtij vendi.

Pasi kishte bërë 4-5 vjet punë si mësues, rakiti u thirr në degën ushtarake të rrethit Dibër, për të kryer shërbimin e detyruar ushtarak, duke e caktuar në reparte speciale, si Planshetist në regjimentin e Marinës në Vlorë. Duke qenë se Rakipi ishte formuar dhe puna e tij si mësues, i kishte dhënë avantazhe dhe në ushtri, ai, si specialist në shtabin e regjimentit, përgatiste kështu kushte që ushtarët të lexonin e të studionin literaturë artistike e politike në bibliotekën e repartit, ku për katër vjet u bë një propagandist i aftë. Për këtë u dekorua me medalje dhe pasi mbaroi ushtrinë u kthye në vendin e tij të lindjes, tek ajo shkollë ku kishte qenë dhe vetë nxënës, për të mësuar e dhënë njohuritë e para bashkëfshatarëve të tij. Dekorata më e madhe e tij qe mësimdhënia për gati 40 vjet.

Pra që nga viti 1955 e deri në vitin 1991 kur ai doli në pension nuk e ndërpreu punën për asnjë ditë. Rakitit i flet sedra, flasin kolegët e tij të punës, eprorët, flasin brezat që ai mësoi dhe edukoi për rreth 40 vjet, i flet shpirti, zemra syri, bëmat, fjala e urtësisë, i flasin provat e tij prej mësuesi e prindi shembullor.

Nderimi në kohë është vlerë për kombin, për brezat. Si drejtues e mësimdhënës i palodhur nëpër vite, si prind i vyer, Rakipi mban disa medalje e dekorata.

Me ndryshimin e sistemit, Rakipi dha një kontribut modest në forcimin e pushtetit demokratik. Dhe pse ka vite që është larguar nga vendlindja, ai e kujton me nostalgji. Ja si e shpjegon bashkëshortja e tij Shahija. Edhe pse kemi rreth 10 vjet që jemi sistemuar në Sukth të Durrësit, ku kemi ndërtuar shtëpi të reja dhe jemi bërë tre fëmijë, Rakipit i rrin mendja dhe e kujton në çdo kohë Bulqizën. Edhe pse është në pension, s'ka pranuar ta transferojë librezën e pensionit në vendbanim, duke u shprehur se të paktën një herë në muaj, shkoj në vendlindje, takoj të afërmit e mi dhe bashkëfshatarët që aq shumë i desha e më deshën.

S'ka si gjurmët e pashlyera të punës, s'ka si krenaria për ç'ka lënë pas, s'ka si nderimi që të bëjnë ish nxënësit që ke mësuar e edukuar. Rakiti sot mban mbi supe mbi 72 vjet, ku në kujtesën e tij kanë bërë vend emrat e nderuar të ish profesorëve të tij si Shefik Osmani e Petro Marko. Por dhe të ish nxënësve të tij, që edhe sot s'i thërrasin në emër por zoti mësues. Ja si e përshkruan një ish nxënës i tij.

"... Edhe pse kryet ta kanë
mbuluar thinjat,
Ndërmend ato sjellin
një emër nderues,
Emrin e dashtun, por si fëmija,
Emrin e thjeshtë, por, të
madh mësues..."

histori

Mustafa Qemal Ataturku dhe lidhjet e tij me Shqipërinë. Një vështrim i shkurtër mbi themeluesin e Turqisë moderne, me origjinë nga Stebleva.

Mustafa Qemal Ataturku, shqiptari nga Stebleva që u bë reformatori dhe krijuesi i Turqisë moderne

Nga: **SAKIP CAMI**

Mustafai ka lindur më 11 mars të vitit 1881. I jati i tij quhej Riza. Llagapi i tyre ka qenë Conka. Tokat e Conkajve janë edhe sot në Steblevë. I pari tyre ka qenë Pirush Conka që ka emigruar në Selanik që në vitin 1861. Rizai ishte nëpunës me shpirt praktik veprimi dhe me mprehtësi e krenari të cilat ja trashëgoi edhe të birit Mustafait.

Mësuesi i matematikës, edhe ai quhej Mustafa, vendosi që ta thërriste Mustafa Qemal (Mustafai i shkëlqyer).

Mustafai ishte djalë i zgjuar por edhe disi i veçuar. Vendosmëria e tij e heshtur për tu bërë dikushi në jetë një ditë shpërtheu edhe hapur: "Do të bëhem, do ta shihni së shpejti." Pas shkollës së mesme në Selanik, në vitin 1895 ai u regjistrua në Liceun Ushtarak të Manastirit. Manastiri në atë kohë ishte bërë qendër revoltash kundër Perandorisë Osmane. Së bashku me Fetiun, një shok nga Ohri mësonin anglisht dhe lexonin Volterin, Rusoin, Monteskjesnë dhe Robespierin. Lexonte aq shumë sa ja tërhoqën vemendjen se kjo ishte shkollë ushtarake dhe jo për letërsi.

Mbas Liceut ushtarak të Manastirit, më 13 mars 1899 mori udhën drejt Stambollit, ku u regjistrua në kursin e këmbësorisë të shkollës ushtarake.

Stambolli ky qytet i madh me kontraste të mëdha politike dhe ekonomike i bëri përshtypje të madhe dhe e forcoi akoma më shumë formimin e tij politik.

Dikur ai i pat thënë një fisniku të huaj: "Nuk jam fisnik si ju, por kam dalë nga gjiri i një populli fisnik." (Revista "Bota e Re" Nr 7 Korçë, 1937)

Rrënjët e tij nga Stebleva e Dibrës

Pleqtë Vahit Ereqi dhe Destan Bala nga Stebleva e Dibrës tregojnë se Mustafa Qemal Ataturku është biri i një nëne prej Sebishti ndërsa i jati i tij ka qenë nga Stebleva.

Ata janë larguar në emigrim në Selanik. Atje ka lindur Mustafa Qemali.

Tokat e tyre në Steblevë janë edhe sot, tokat e Conkajve poshtë malit të Osojit. Vetëm për të ndërtuar çezmën në vendin e quajtur Terzicë, Mustafai ka paguar dy qese me flori. Rrënjët e tij shqiptare prej fshatit Steblevë të Dibrës i tregon edhe ngjarja që po ju tregojmë:

Një steblevas nga Bandajt në Stamboll në një kafe vret Prefektin e qytetit sepse ai shan Shqipërinë. E dënojnë me vdekje. Një grup steblevas shkojnë te Qemal Ataturku dhe i kërkojnë që t'i falë jetën.

Mustafa Qemali ka thënë: "Për ta vrarë nuk e vrasim, por jam i detyruar ta internoj".

Mustafa Qemal Ataturku dhe Shqipëria

Mustafa Qemal Ataturkut, sekretari i solli për të firmosur një listë me emrat e disa shqiptarëve, që do të shpërnguleshin nga Turqia.

Ataturku, pasi lexoi emrat, mori stilolapsin dhe në krye të listës vuri emrin e tij.

-Zotëri, nuk e kuptoj, përse e vutë emrin tuaj në krye të listës, pyeti sekretari i habitur.

-E vura, sepse i pari që duhet të shpëngulem nga Turqia, duhet të jem unë, sepse edhe unë jam shqiptar, u përgjegj Ataturku.

Shpërngulja nga Shqipëria

Në vitin 1861 janë larguar nga Stebleva e Dibrës 14 familje për në Selanik, ndër to edhe familja e Pirush Conkos dhe Vesel Kuçukut. Familja Kuçuku pas 40 vjetësh kthehet në Shqipëri, por jo në Steblevë, por në Tiranë, ku banojnë edhe sot. Kolegu im ushtaraku Halil Kuçuku vazhdon të shërbejë në rradhët e Forcave të Armatosura Shqiptare në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ndërsa familja e Pirush Conkos largohet nga Selaniku dhe vendoset në Stamboll rreth vitit 1900. Nipi i tij Mustafa Qemali u bë ushtarak i lartë, gjeneral dhe më vonë Presidenti i Turqisë së Re. Në vitin 1936 është zhvilluar në Steblevë gjyqi për pronësinë e truallit të Conkajve. Gjyqi me gjyqtarë të ardhur nga Tirana dëgjoi deponimet e tre pleqve të fshatit Vesel Kuçuku, Sadik Avda dhe Jonuz Disha. Vesel Kuçuku që banonte në atë kohë (1936) në Tiranë , pas kthimit nga Selaniku vërtetoi se trualli ku është sot shtëpia e Faslli Kuburit (nip tek dera e Conkajve) është trualli i Pirush Conkos, gjyshit të Qemal Ataturkut. Gjyqi u zhvillua ndërmjet Jashar Lamës dhe Faslli Kuburit dhe u fitua nga ky i fundit, pasi ky ishte nip tek Conkajt dhe i vetmi i afërt që kishte mbetur.

Takimi me Qemal Ataturkun dhe pohimi i tij mbi origjinën e tij

Në vitin 1926 Dail Ereqi nga Gjinoveci dhe Xhel Agushi nga Stebleva, kurbetli dhe specialistë ndërtimi në Stamboll janë takuar rastësisht me Qemal Ataturkun.

Ndërsa po punonin për restaurimin e një xhamie ata kanë marrë përgëzimet e kryetarit të shtetit turk Qemal Ataturku.

-Punë të mbarë, o ustallarë, i përshëndet Qemali.

-Mbarësi e mirësi paç, o njeri, ju përgjigjën me respekt, por pa e ditur se kush ishte por vetëm duke e marrë me mend sepse ishte i shoqëruar nga njerëz që e ruanin.

-Ju lumshin duart, qenkeni mjeshtër të zot e duar artë. E paskeni bërë më të mirë se ç'ka qenë para shkatrrimit nga lufta. Nga ju kemi ?

-Nga Shqipëria, i përgjigjemi.

-Po nga çfarë krahine ? pyeti prapë ai.

-Jemi nga Golloborda, njëri nga Gjinoveci dhe tjetri nga Sebishti, ju përgjigjëm, pasi u bindëm se ai e njihte mirë Shqipërinë dhe pasi kishim marrë komplimentat për punën e mirë.

Ataturku nxorri nga xhepi një bllok dhe na tha: "Edhe unë andej jam, nga Stebleva. Gjyshi im më ka lënë amanet arën e Conkajve, të cilën e shprehu në maqedonisht "Conkojca Ograda".

-A keni ndonjë nevojë?

Ishte rasti për t'u shprehur. Kishte ardhur e mira tek dera.

-Mbetëm kurbetçinj, gjithë jetën pa familje, i thamë.

Kaq u desh dhe na u bë menjëherë nështetësia turke dhe na u dha banesë bile edhe më të mirë se vetë turqit.

Ekspozitë në Tiranë kushtuar Ataturkut

Në vitin 1984. në kuadrin e 60 vjetorit të formimit të shtetit të ri turk, u hap në Pallatin e Kulturës në Tiranë, një ekspozitë kushtuar Turqisë moderne dhe arkitektit të këtij shteti modern Ataturkut. Edhe në pemën e gjenezës së familjes së Qemal Ataturkut vërtetohet origjina e tij shqiptare dhe vendlindja etij në Selanik. Ciceroni i ekspozitës shtetas turk me origjinë kosovare pohoi nën zë se Ataturku është me origjinë nga Dibra e Shqipërisë, tregon Ramazan Hoxha, autor i librit: "Stebleva, histori dhe figura"

Shoqëria e babait të Qemal Stafës me Mustafa Qemalin (Ataturkun)

Garip Disha nga Stebleva tregon edhe për lidhjen e babait të Qemal Stafës (Hero i Popullit) me Mustafa Qemalin (Ataturkun).



MUSTAFA QEMAL ATATURKU

Siç dihet babai i Qemal Stafës ka qenë nga fshati Zabzun i Dibrës. Edhe sot egziston fisi Stafa në Zabzun. Më vonë familja e gjyshit të Qemalit shpërngulet nga Zabzuni për në Elbasan. Babai i Qemalit pas përfundimeve të studimeve emërohet në kohën e Zogut nëpunës në Shkodër ku lind edhe Qemali. Mustafa Qemali ishte me origjinë nga Stebleva e Dibrës. Edhe sot egziston ara e Conkajve, pronë e gjyshit të Mustafait dhe trualli i Faslli Kuburit , nipi i Mustafait.

I jati i Qemal Stafës dhe Mustafa Qemali kanë mbaruar shkollën e lartë ushtarake në Stamboll. Në shenjë të miqësisë së tyre i jati i Qemal Stafës ja vuri emrin djalit të tij Qemal sikurse shoku i tij Mustafa Qemali. Qemal në turqisht do të thotë i shkëlqyer dhe babai i Qemalit dëshironte që djali i ardhshëm i tij të bëhej i shkëlqyer , Qemal.

Simbolet në emrin e tij

Nga emri i tij i tanishëm Mustafa Qemal Ataturk, vetëm emri Mustafa është emri i tij i vjetër. Qemal e ka marrë për mbiemër për faktin se ishte qemal (kemal) turqisht do të thotë i shkëlqyeshëm dhe me të vërtetë të gjitha studimet Mustafai i mbaroi shkëlqyeshëm, por këtë emër ja dha mësuesi i tij i matematikës në shkollën e mesme që quhej edhe ai Mustafa, por që këtë nxënës e vlerësonte kemal (të shkëlqyer). Ataturk është emri apo pseudonimi që i vuri populli turk pas revolucionit që kreu në dobi të Turqisë moderne, pra i vunë emrin baba i Turqisë (Ataturk)

Mustafa Qemal Ataturku është i vetmi burrë shteti, emrin e të cilit e mban rendi që krijoi, sepse është themeluesi i Turqisë moderne. Ai bëri shëndrrimin e Turqisë nga Perandori (Sulltanat) në Republikë.

Doktrina e filozofike e ideuar dhe e zbatuar shkëlqyeshëm nga Mustafa Qemal Ataturku është doktrinë e së ardhmes.

Për Mustafa Qemalin kategoritë "liri" dhe "pavarësi" qëndrojnë në themel të vetëqënies së popujve. Edhe sot në çdo cep të Turqisë do të shohësh thënien e tij lapidare dhe aktuale "Një popull pa liri është i dënuar me vdekje ose të zhduket"

Ai vinte drejtësinë mbi forcën, ndërsa i kushtonte rëndësi të dorës së parë forcës së brendshme të popullit. Ataturku ka qenë mik i madh i Shqipërisë dhe i popullit shqiptar. Ai është me origjinë shqiptare (dibrane), lindur në Selanik të Maqedonisë Greke dhe edukuar në shkollat ushtarake Turke të cilat do ta bënin gjeneral dhe udhëheqësin e Turqisë moderne.

Ai nuk e mohonte këtë fakt, përkundrasi duke qenë i tillë, ai ishte mik i të gjithë popujve.

KUSH ISHTE MUSTAFA QEMAL ATATURKU?

Mustafai ka lindur më 11 mars të vitit 1881. I jati i tij quhej Ali Rizai.

E ëma e Mustafait ishte Zybejde Hanëmi. Meqenëse i jati i Mustafait vdiq shpejt, nëna e Mustafait mori fëmijtë dhe shkoi tek i vëllai, i cili kishte emigruar më parë në një fshat pranë Selanikut të Greqisë.

E jëma megjithse në kushte të vështira ekonomike e regjistroi Mustafain në shkollën e mesme, ku ai shkëlqeu veçanërisht në matematikë. Mësuesi i matematikës, edhe ai quhej Mustafa, vendosi që ta thërriste Mustafa Qemal (Mustafai i shkëlqyer).

Në vitin 1895 ai u regjistrua në Liceun Ushtarak të Manastirit. Më 13 mars 1899 mori udhën drejt Stambollit, ku u regjistrua në kursin e këmbësorisë të shkollës ushtarake.

Më 1902, fill pas përfundimit të shkollës ushtarake, Mustafa Qemali hyri në Akademinë e Luftës. Me 11 janar 1905 Mustafa Qemali doli nga Akademia e Luftës me gradën kapiten. Ishte 24 vjeç. Bashkë me disa shokë, themeluan një shoqatë të fshehtë të cilën e pagëzuan: "Atdhe e liri". Mustafain e internuan në Damask me urdhër të Sulltan Avdyl Hamitit. Në shtator 1907 Mustafa Qemali u caktua në Shtabin e Armatës së III në Selanik, ku zgjeroi veprimtarinë e tij me ish shokët e tij të shkollës. Idetë e tij ishin për Republikën moderne të Turqisë së vertetë. Fillimi i Luftës së Parë Botërore e gjeti Mustafa Qemalin atashe ushtarak në Sofie. Më 2 shtator 1914 Perandoria Osmane hyri në luftë si aleate e Gjermanisë dhe Austrisë. Mustafa Qemali në Çana Kala (Dardanele) mori drejtimin e Divizionit të 19-të në prill të vitit 1915. Pas luftimesh të pandërprera, më 19 dhjetor 1915, forcat e Antantës u larguan përfundimisht nga Çana Kalaja duke humbur 250 mijë ushtarë.

Heroizmi që treguan forcat e komanduara nga Mustafa Qemali, shërbimet e mëdha që ato i sollën mbrojtjes së vendit, u përhapën anë e mbanë Turqisë. Vitet 1918-1920 do ta evidentonin Mustafa Qemalin si luftëtar të madh në mbrojtje të atdheut, të Turqisë.

Më 30 prill 1919, Mustafa Qemali pranoi detyrën e inspektorit të Forcave të Armatës së 4-t dhe të qeveritarit të vilajeteve të Anadollit, detyrë me të cilën fitoi besimin e ushtrisë së mbetur. Mustafai ishte personi kryesor që ishte në gjendje të kundërshtonte fuqitë e mëdha fituese të Luftës së Parë Botërore dhe të mos lejonte dobësimin e Turqisë si shtet. Për këtë ai fitoi edhe një mbështetje mbarë popullore.

Me 23 korrik 1919, pjesa më e madhe e delegatve të provincave lindore të Turqisë u mblodhën në Erzurum në një Kongres të jshtëzakonshëm në kushte ilegale, krijuan një këshill kombëtar të kryesuar nga Mustafa Qemali. Asnjë urdhër për arrestimin apo dënimin e Mustafa Qemalit nuk mundi të zbatohej. Me vendimet e Kongresit të Erzurumit u njohën edhe vendet e Antantës, SHBA dhe Anglia. Në favor të veprimeve të Mustafa Qemalit reagoi edhe Shoqata e të Drejtave të Njeriut. Aleatët u bindën se kishin të bënin me një lëvizje masive dhe nuk mund të rrinin indiferent ndaj saj. Me vendim të Komitetit Përfaqësues të drejtuar nga Mustafa Qemali me 27 dhjetor 1919, Ankaraja u bë qendra e luftës kombëtare dhe më vonë kryeqyteti i Turqisë moderne. Forcat e Antantës nuk ishin dakord me vendimet e Parlamentit të Ri turk të janarit 1920 dhe me Paktin Kombëtar të tij për mbrojtjen e Turqisë dhe të Stambollit dhe e pushtuan atë. Fuqinë dhe drejtimin e mori Mustafa Qemali, i cili i përzuri forcat e Antantës dhe shpalli Ansamblenë Kombëtare të Turqisë si i vetmi pushtet ligjvënës në përputhje me Paktin Kombëtar për ruajtjen e teritorit të Turqisë.

Më 23 prill 1920 Ansambleja e Parë Kombëtare bëri mbledhjen e parë në Ankara. Kjo Ansamble zgjodhi kryetar të saj dhe të Komitetit Ekzekutiv (Qeverisë) Mustafa Qemalin. Mustafa Qemali shkatrroi sistemin e Sulltanatit dhe Kalifatit dhe formoi republikën. Kjo ishte një arritje e madhe, që e lejoi atë të fillonte dhe të zbatonte reformat e mëdha demokratike në të gjitha drejtimet, në edukim, drejtësi, financa, shëndetësi, kulturë, ushtri etj. Vitet 1924-1938 ishin vitet e këtyre reformave që krijuan Turqinë e re moderne që kemi sot.

Lidhja e Kombeve më 1938 e ka quajtur Mustafa Qemal Ataturkun, shërbëtor gjenial të paqes. Ataturku është i vetmi shtetar që kombi e ka quajtur baba të kombit.

Poetët dibranë, Arjana Tollja dhe Agron Sela botojnë poezitë e tyre, plot ndjenjë dhe ritëm.

Poezi që prek telat e shpirtit

Është një guxim i çartur prej poeti të vërtetë, të marrësh përsipër të shkruash poezi në një kohë si kjo e jona, ku letërsia, e sidomos ajo shqipe, po mbytet nga fryma e një bote komerciale dhe të egër, nga indiferenca dhe shpërfillja, që nganjëherë, për çudi, shkon gjer në tallje.

Mirëpo, soj i poetëve, i atyre poetëve që e kanë krijimtarinë dhimbje dhe shqetësim, nuk jeton dot pa hedhur në letër, një ndjenjë, një mendim pirat, një shqetësim njerëzor, apo një figurë, imazhi i së cilës, mund të të ngelet në mendje, mbase për gjithë jetën.

Nga një soj i tillë është edhe poeti Agron Sela, poezitë e të cilit, të them të drejtën, i mora në dorë me një lloj skepticizmi, por, që më befasuan, që në vargjet e para.

Unë nuk marr përsipër të bëj këtu komente të gjata, pasi poezia, madje arti në përgjithësi, gjykohet mbi bazën e eksperiencave individuale. Kështu, lexuesi i kualifikuar, ai lexuesi individual dhe jo kolektiv, që e pëlqen artin poetik, që e ndjen atë me shpirt dhe mendje, do të jetë në gjendje ta kuptojë se poezia e poetit Agron Sela, është në rrugë të mbarë. Ai do të kuptojë, që kjo lëndë poetike, nuk është mbrujtur, në një segment të shkurtër kohor, por është një varg i gjatë sprovash e përpjekjesh për ta gjetur e thënë fjalën e mençur, fjalën që di të prekë telat e shpirtit, kur "Tina elegante", edhe pse është një punëtore e thjeshtë, kalon pranë poetit duke ecur si një princeshë dhe kur ikën, bashkë me aromën e parfumit të saj, lë pas edhe poezinë.

Edhe pse ky është volumi i parë poetik, që i shkon lexuesit në dorë, jam i bindur, që autori, ka shkruar ndoshta, qysh në rininë e tij të hershme, kur ka filluar të ndjejë e kuptojë, që jeta në përgjithësi, nuk është vetëm një nënë e dhembshur, por është edhe një njerkë e pashpirt dhe se duhet jetuar duke ia shfletuar me gishta pejzat, duke e prekur me mollëza çdo ditë, duke ndjerë gjer në kockë vuajtjen dhe mungesat, duke provuar vetminë, mërzinë e thellë, çastet e gëzueshme dhe ato të hidhurat. Sepse, nuk ke si të mos i ndjesh në shpirt vargje si këto: "Bora e fundit e lodhi qytetin. / Si një fustan i leckosur, i flakur tej, / Njerëzit e shkelin rrugëve" (Bora e fundit). Ose: "Edhe pse nata është e heshtur / E qetë dhe pa zhurmë / S'është paqe / Një zë vibron tej, pejzave të errësirës / Nga ku rreket të shfaqet / Një agullim mëngjesi". (S'është paqe). Ose: "Nga guzhinat e fqinjëve / Krimbat krimbin dheun / Që të vjellë atdheu".(Krimbat)

Pa marrë përsipër të bëj etiketime në lëndën poetike të Agronit, e them me plot bindje, që ka në këtë volum vargje të krahasueshme me ato të poetëve më të mirë. Unë, sinqerisht e përgëzoj poetin A. Sela për vargjet e tij të bukura dhe shpresoj, që në ditët, që do vijnë, të kemi në dorë një spirale tjetër me poezi të tij, ndoshta edhe më të arrira.

R. Gjini.



POEZI NGA AGRON SELA

NJË FILXHAN KAFE

Mëngjezi ende fërkon sytë.
Aromat e tua
Më hapin dritaren,
Që të shoh buzëqeshjen
e ditës
Duke çelur si manushaqe
Vargun tim të mbërdhirë
Nga cikma e jetës.

TË PRES

Që atë çast që u largove
Zemra ime ravgon
Si të jemë
Plagosur në betejë.

Sytë e mi dritë mbyllur
Si dy yje të harruar
Të presin për t'i ndritur.

E DASHUR

Si flutur mbështet kokën
Në petalet e zemrës sime.
Gonxhe e kurorës së bukurisë,
Përqafon buzëqeshjet
E shpresës sime
Me syt' e zjarrtë të dashurisë.

Ashtu, e brishtë
Si lulekuqe flakëruese.
Puthja ime e kallur
Si llava e vullkanit
Rrjedh trupit tënd,
Që të ndezë zjarrin e dëshirës
Në shtegun e dashurisë.

PAQE

Edhe pse nata ësht'
e heshtun,
E qetë, pa zhurmë,
S'është paqe.
Një zë vibron tej,
pejzave të errësirës
Nga ku rreket të shfaqet
Një agullim mëngjezi.

FJALA E NËNËS

Eca që në gjenezë,
Si buzëqeshja e diellit n'agim;
Dijet të gjejn' strehë,
Nëpër motet e zbehta,
djal' im.

Mua, që mëkova ungjijtë,
Kush ma vodhi perëndinë?

FOTOGRAFIA

Ti iu shmange aparatit
fotografik
Nga pësh-pështet e njerëzve,
Por nga albumi i shpirtit im
S'mundesh me ik.

Sërish ta shoh
Buzëqeshjen në buzë
Si dielli në perëndim
Dhe më kujton kohën
Kur vrapoje drejt meje.

Do ia zbath këpucët kohës
Që vrapi i saj të ndalet
Në rininë e bukur.
Sepse ende më don e të dua.

VJERSHAVE

Sa netë mbeta pa gjumë
Dhe i lodhur.
Desha të rriteni të bukura,
Të mira.
Lodhjen e munda
Me buzëqeshjen tuaj.

KUR TË SHOH

Kur të shoh,
Zemra ime si deti me tallaz
Përplas valët
Në gjoksin tim-shkëmb.
Sepse ti s'je veç dita me diell
Por je dhe stuhia.

PEIZAZH VENDLINDJE

Moti shëndrit qeleshet
e maleve
Për të ndezur dritën e kohës,
Kënga përqaf cicërimat e
zogjve,
Lumejntë mbledhin rrëket' e
borës.

Ret' e zeza largohen dhe
Acarit të gjatë i këputen këmbët;
Ninullat nëpër djepa rrallë
dëgjohen,
Në votrën pa rini, jeta
rrudhet.

VAJZËS

Me gjuhën e ambël
Që më përqafoj nëna,
Si kristal të pastërt
Në votrat tona;
Nga fjala e saj
Emnin ta zgjodha
Bija ime, Bora.

DITA E VERËS

Ejani të kremtojmë
Ditën e Verës!
Buzëqeshjen e kryemotmotin
tone,
Festën që i këndon jetës
Me bukurinë që s'perëndon.

Mbledhim lulet e para
Të gëzuar, në muajin abib
Ku motit i çelet dera.
E stolisur me çdo pip.

Poezi nga Arjana Tollja

VETMI MAGJISTRICË

Kam ftohtë,
sa të gjitha zjarret e kësaj bote
s'do të më ngrohin dot.
Nën rrezet e të gjithë diejve,
prapë s'do të ndieja ngrohtë.

Kam ftohtë,
edhe pse s'dridhem,
unë sërish kam shumë ftohtë.
Vetmia mblodhi tek unë
tërë ajzbergët që ka kjo botë.


Kam ftohtë,
i gjithë trupi më dridhet,
brenda, thellë në shpirt.
Por unë do i vras acaret
dhe vetminë magjistricë.

THIRRJE PËR PAQE

Sa orë, sa ditë, sa vjet, sa shekuj
kemi që thërrasim për paqe
por njerëzit e luftërave nuk na dëgjojnë,
se ngushticat e errëta të shpirtrave të tyre
nuk mund t'i kapin thirrjet në jehonë.

Sa shekuj kemi që thërrasim për paqe,
të gjithë ne thërrasim, ata s'na dëgjojnë.
janë krismat e armëve,
britmat e viktimave,
tingëllimat e monedhave
që s'i lënë të na dëgjojnë...

Sa shekuj kemi që thërrasim për paqe?!
Sa shekuj kemi që ata s'na dëgjojnë?!



traditë

Kënga qytetare dibrane dhe zhvillimet e saj. Si lindi dhe cilat ishin zhvillimet e saj pas ndarjes së Dibrës?

Kënga qytetare dibrane



Nga **PËRPARIM TOMCINI**

Kënga qytetare dibrane e ka zanafillën e saj nga fundi i shek. XIX dhe fillimit të shek. XX. Si bartës kryesor në fillimet e para të kësaj gjinie njihet këngëtari popullor Abdyl Bej Sturçe nga qyteti i Dibrës së Madhe i cili e trashëgoi talentin e tij edhe ndër breza të tjerë të familjes Sturçe që vijojnë edhe në ditët e sotme. Të tillë janë Tofiku (i nipi) i cili jetoi deri në vitet 80 të shekullit të kaluar dhe i ndjekur nga fëmijët e tij (Tofiku), Abdyli, Nadirja dhe Aliu që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të këndojnë me pasion këngën qytetare dibrane.

Me ndarjen e kufijve në vitin 1913 shumë qytetarë dibranë emigruan në vise të ndryshme të Shqipërisë po më së shumti në qytetin e Peshkopisë ku sollën me vete dhe kultivuan më tej këngën qytetare e cila nuk ekzistonte deri në atë kohë qytet. Të tillë janë (emigrantë) Tofik Sturçe, Xhilk Vojka, Vasfi Xheladini, Munir Shehu, Muharrem Zajmi, Besim Çutra etj.

Deri në vitit 1944 pati ardhje të vazhdueshme të familjeve nga Dibra e Madhe në qytetin e Peshkopisë, ndër ta ishte dhe kompozitori Munir Shehu i cili jo vetëm që krijoi këngë të tilla si: Katundarja në katund të ri, Bulqizake etj. por duke qenë mësues muzike në shkollën e mesme pedagogjike të qytetit Peshkopi ai e kultivoi këngën qytetare edhe tek brezat e ri të këtij qyteti duke hedhur bazat fillestare të shkrimit të këngës me nota. Shumë e veçantë në këtë periudhë ka qenë edhe prezenca dhe puna si krijues dhe pedagog e kompozitorit shkodran Tonin Rota i cili gërshetoi talentin, profesionalizmin dhe traditën shkodrane me këngën qytetare dhe fshatare dibrane duke krijuar kështu një tip të ri këngë qytetare të cilat njihen edhe si "Këngët e Toninit". Të tilla janë "Jepma mollën", "Ma ke gishtin për unazë", "Topolake" etj., që u bënë shumë të njohura nën interpretimin e këngëtarëve; Haziz Ndreu, Skënder Cala, Melita Shehu, Abdyl Sturçe etj.

Të së njëjtës periudhë janë dhe krijimet e kompozitorit Muharrem Xhediku nga Zall Dardha, i cili nuk jetonte në Peshkopi, por gjithsesi në titujt e këngëve të tij ndjehen qartë intonacionet e këngës dibrane si te kënga brilante "Cuca e Radomirës".

Pas viteve '70 kënga qytetare mori një zhvillim shumë të madh falë punës profesionale të një grupi të konsiderueshëm artistësh krijuesish dhe këngëtarë të cilët filluan të organizojnë edhe festivalet e para të këngës dibrane, numri i të cilëve arriti deri në 19 të tillë. Në këtë periudhë shquhet puna e kompozitorit Zef Çoba nga Shkodra, Lahim Kola, Ymer Seferi, Përparim Tomçini, Edmond Zhulali, Isak Shehu e të tjerë si dhe këngëtarë të tillë si Flora Toska, Fatime Bojaxhiu, Zyrka Mati, Lirie Rasha, Sahje Poleshi, Vera Laçi, Niovi Samara, Flora Shabani, Roza Paçuku e shumë e shumë të tjerë të cilët krijuan një terren eksperiencash edhe për qytete të tjera të Shqipërisë me histori më të hershme në kultivimin e këngës qytetare.

Me ndarjen e Dibrave kënga qytetare dibrane mori dy zhvillime të ndryshme. Në qytetin e Peshkopisë siç thamë më sipër u gërshetuan tradita qytetare e Dibrës së Madhe, eksperienca shkodrane dhe motivet fshatare kryesisht të zonave perëndimore të Peshkopisë. Ndërsa në Dibrën e Madhe deri para se të hapeshin kufijtë në vitet '90 (shekulli i kaluar) nuk kishim informacion të saktë rreth zhvillimit dhe kultivimit të kësaj gjinie të këngës.

Pas hapjes së kufijve mësuam se atje vazhdonte të ruhet tradita dhe njëkohësisht vend të veçantë në repertorin e këngës qytetare të Dibrës së Madhe tashmë zinin edhe këngët qytetare të Elbasanit (Shkova në Elbasan), këngët e Tiranës "Rrem Tirana", "Gani beg Toptani" etj., si dhe një sërë serenatash korçare të cilat janë bërë njësh në repertorin autentik të Dibrës. Të tilla këngë që ngjajne me serenatat korçare janë "kur hana del", "gurët e Sokakut", "Dy lule të bardha" etj., të kënduara nga Violeta Turkeshi, merita Maqellara, Agron Maqellara, Sajmir Shehu etj.

Me krijimin e shoqërisë kulturore-artistike "Liman Kaba" pas viteve '70 (shek. i kaluar) ra në sy edhe puna krijuese e kompozitorit Musa Piperku me këngët "Dasma e malësorit", "Barinjtë e Korabit", "Në Prizren në të bukurin vend" si dhe kantautori Haxhi Maqellara me këngët "Qaj moj nane", "Hibe Palikuqi" etj., si dhe shumë e shumë artistë krijues dhe këngëtarë dibranë të asaj periudhe u bënë flamurtarë të ruajtjes, kultivimit, krijimit dhe ekspozimit të vlerave kombëtare shqiptare në mbarë hapësirat e ish Jugosllavisë.

Sot krijimi dhe kultivimi i këngës qytetare në Peshkopi për shkak të krizave të ndryshme politike dhe ekonomike është vështirësuar shumë. Megjithatë organizimi i festivalit kombëtar të këngës qytetare që zhvillohet në qytetin e Elbasanit krijon mundësi që së paku të arrijmë të shfrytëzojmë dhe të shpëtojmë sa të mundemi nga ajo që kemi trashëguar.

PËR KOSOVËN TË LOBOJË EDHE LIBRI I LULJETA SELIMIT

Libër që duhet shpërndarë në tërë botën

Reagimi i këtyre ditëve i opozitës kosovare dhe i analistëve kosovarë se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë aqë sa duhet në drejtim të lobimit për njohjen sa më numerike Pë pavarësisë së Kosovës, imponon nevojën e kontributit tonë të gjithanshëm për këtë lobim.

Sot kur nevojitet që sa më shumë shtete ta njohin Pavarësinë e Kosovës. Sot kur shumë shtete ende janë të pavendosura për njohjen e Pavarësisë së Kosovës.

Sot kur kemi lobimin tejet agresiv të diplomacisë serbo-ruse për pengimin dhe zvarritjen e njohjes së Pavarësisë së Kosovës nëpërmjet formave të ndryshme, kur kemi deklaratat e lidershipit serb se nuk do ta njohin kurrë Pavarësinë e Kosovës, kur kemi deklaratat luftënxitëse të priftërinjve serbë ndaj Pavarësisë së Kosovës, rritet edhe domosdoshmëria e përkthimit të librit "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë" të autores Luljeta Selimi, dhe shpërndarjes te tërë burshtetasit e botës si edhe një argument i fuqishëm për njohjen e Pavarësisë së Kosovës.



E përditshmja "Fakti" që botohet në Shkup kohë më parë këtë roman e botoi në formë fejtoni dhe zgjoi interesim të jashtëzakonshëm te lexuesit. Po kjo e përditshme si edhe gazeta mujore "Rruga e Arbërit" që botohet në Tiranë, katër herë radhazi nëpëmjet teksteve të botuara bënë apelin publik për përkthimin dhe shpërndarjen e këtij libri në tërë botën, por çdo gjë hasi në vesh të shurdhër.

Sensibilizimin dhe shqetësimin që ky libër e arrin te lexuesi , imponon nevojën që Qeveria e Kosovës, Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, Lidhja Shqiptare në Botë, biznesmenët shqiptarë, apo ndonjë shoqatë a institucion tjetër, të angazhohen sa më parë ta përkthejnë këtë libër në gjuhët e huaja dhe tua dërgojnë tërë ambasadorëve në Kombet e Bashkuara, në Unionin Evropian dhe tërë burshtetasve, për të parë dhe për tu bindur se serbët përveç vrasjeve e djegieve në Kosovë, kanë bërë edhe dhunimet nga më makabëre që mund ta imagjinojë mëndja e njeriut dhe se një gjë të tillë nuk do ta bënin as shtazët më të egra.

Për të kuptuar se sa shtazarake kanë qenë këto dhunime të femrave kosovare nga ushtarët e policët serbë, po pasqyroj vetëm disa grimca nga ky libër. " Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare".

Një nga mjeket deklaron se,"Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet gjenitale i kishn futur rërë, këmbët i kishte të gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishte të vizatuar kryqin serb".

Ose rrëfimet e tjera," Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vrarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij," Pasi ma vranë djalin, mua më çnderuan disa ditë me radhë", "Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan", "Më dhunuan para syve të nënës", "Më dunuan e ma prenë gjirin", "Cigaren e ndezur e fiki në gjinjtë e mi", "Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, "Më detyronin t'i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë", "Pasi më dhunuan, m'i hoqën thonjtë me dana", "Motrën e mbytën me kundak të pushkës", "14-vjeçarja u dhunua në borë", "Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus", "Më çnderuan para syve të babait dhe nënës", "Në muajin e tetë të shtatzanisë më përdhunoi para vjehrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëminë e vdekur", " Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb", "Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale"....

Çdo i huaj që do ta lexonte këtë libër do ta kuptonte më së miri se çfarë krimesh kanë bërë serbët ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe se shteti i ri i Kosovës duhet pranuar pa mëdyshje.

REXHEP TORTE

Skënder Xhilaga dhe sukseset e tij në arkitekturën moderne botërore.
Një ndër punët e tij vlerësohet nga revista e njohur amerikane, "Forbes"

ARKITEKTI SKENDER XHILAGA,

dibrani që ndërtoi "Madison Square Garden"

Revista e famshme amerikane "Forbes", shpalli 10 stadiumet më të shtrejta në botë

BEQIR SINA, *New York*

NEW YORK CITY : Revista e mirënjohur amerikane "Forbes", në një studim statistikor të publikuar në numërin e fundit të sajë nxorri rezultatet të cilat klasifikojnë sipas çmimit që kanë 10 stadiumet më të shtrejta të Botës. Rezultati bazohet tek vlera e cila ka kushtuar stadiumi.



Në vend të parë, sipas rezultateve qëndron legjenda e futbollit Anglezë, "Wembley Stadium" në kryeqytetin e Britanisë së Madhe, Londor. Ky stadium ka kushtuar 1.5 miliardë dollar. Kapaciteti e tij është: 90,000 dhe është Inaguruar në vitin 2006.

Në vend të dytë ndodhet sipas revistës Forbes,"Olympic Stadium" në Qytetin Montreal, Kanada Ky stadium ka kushtuar: 1.4 miliardë dollarë, Kapaciteti i tij është 60,000, i Inaguruar në vitin 1976.

I treti është ndërtesa "mit", pallati i sporitit siç e quajm ne shqiptarët stadiumin e lojrave me dorë "Madison Square Garden" . Ky stadium është ndërtuar në zemrën e qytetit fantastik, metropoilit të botës, Neë Yorkut, i njohur ndryshe edhe si qyteti i gradaçieleve (skyscrapers) i "Qiejgërvishtëvesve". Lojrat që luhen në të, janë të shumta dhe i përkasin sporteve të sallave të mbyllura, si: Boksi, Basketbolli, Hokeji, Gjimnastika dhe sporte të tjera. Ky është stadiumi legjendar i skuadrës së basketbollit të qytetit të Nju Jorkut, skuadrës NY Knicks dhe skuadrës se hokeit mbi akull New York Rangers. Në këtë stadium janë zhvilluar edhe ndeshjet historike të boksit nga legjendat botëre të këtij lloj sporti. Këngëtar nga më të famëshmit në Amerikë kanë mbajtur koncerte në këtë stadium.

Stadiumi i famëshëm "Madison Square Garden", është vepër e disa artitekëve. Mes tyre shquhet dhe artitekti i njohur shqiptar, në SHBA-së, Skender Xhilaga, i cili së bashku me familjen e tij u arratisën nga Dibra, në kohën kur Shqipërinë e sundonte rregjimit komunistë. Ata ikën për të realizuar ëndrren amerikane. Vetëm këtu pinjolli i njërës prej familjeve më në zë në Dibër, familje patriote, trime dhe bujare , do të bëhej realizues i projekteve të ndërtesave me shumë famë në Amerikë, të tilla si: "International Design Center", "Rockfeller Center","Lincoln Center for the Performing Arts", "Madison Square Garden" dhe dhjetëra të tjera me shumë famë nëpër botë. Projektet e tij shtrihen në të gjithë globin, që nga Amerika, vendet Arabe, Malajzi, Japoni etj. Artitekti dibran Skënder Xhilaga në SHBA-së, është edhe anëtarë i projektit të Universitetit të Rijadit në Arabinë Saudite, me kapacitet 35 mijë studentë, një ndër më të medhatë në botë.



Në vend të parë, sipas rezultateve qëndron legjenda e futbollit Anglezë, "Wembley Stadium" në kryeqytetin e Britanisë së Madhe, Londor. Ky stadium ka kushtuar 1.5 miliardë dollar. Kapaciteti e tij është: 90,000 dhe është Inaguruar në vitin 2006

PAJTOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Pajtimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: Cel: 068 31 19 232 ose në numrin fiks 22 33 283.

Pajtimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "Fleta XXI", pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. tel: 0218 4233.

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

- KËRKOHEN KORRESPONDENTË NE RRETHET DIBËR, LEZHË, DURRËS.

- BENI NJOFTIMIN TUAJ TE BIZNESIT

Bëhuni pjesë e gazetës!

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
www.dibra.org

botime & studio grafike

libra-revista
gazeta -fletëpalosje
postera-broshura
kartolina-ftesa
kartvizita
shërbim fotografik

mirë.... bukur.... lirë....

00355 4 22 33 283
069 20 68 603
mbbotime@gmail.com

Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **2233 283**.